

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6501  
31 dhjetor 2021 dhe  
1, 2 e 3 janar 2022  
çmimi 1 €



## PADREJTËSIA SPECIALE

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# Vit zhgënjyjes

“Epoka e re” të gjithë qytetarëve  
ua uron Vitin e Ri 2022!



**KNAUF INSULATION**  
Mob: 049/335-221  
049/335-224  
049/334-224  
*Është koha ta kërcejmë energjinë!*  
[www.knaufinsulation.com/al](http://www.knaufinsulation.com/al)

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
**PUTZ**  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL • BUNJAKOL • EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666





# Kosova më 2021: Vit zgjedhësh, “Ballkani i hapur”, Covid-i dhe energjia elektrike

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Viti 2021 u përcoll me shumë ngjarje të ndryshme, por ato që lanë më shumë gjurmë ishin zgjedhjet parlamentare dhe lokale, iniciativa “Ballkani i hapur”, situata me Covid-19 dhe energjia elektrike. Në fillim të janarit të vitit 2021 Kuvendi i Kosovës u

shpërnda dhe më 14 shkurt Kosova mbajti zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në të cilat Lëvizja Vetëvendosje, e përkrahur nga “Lista Guxo” që drejtohet nga Vjosa Osmani, doli fituese me mbi 50 për qind të votave. Pas këtij rezultati lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe Vjosa Osmani, dolën së bashku para qytetarëve dhe zgjedhjet e 14 shkurtit i cilësuan referendum.

Albin Kurti për herë të dytë u zgjodh kryeministër i Kosovës më 22 mars. Më 4 prill Kuvendi i Kosovës zgjodhi me 71 vota Vjosa Osmanin presidente të vendit, në një seancë të jashtëzakonshme, duke shmangur krizën politike, çuarjen e vendit në zgjedhje të parakohshme. Pas zgjedhjeve parlamentare, tetë muaj më vonë Kosova mbajti zgjedhjet komunale.

Por në këto zgjedhje nuk u konfirmua mbështetja e 14 shkurtit për Lëvizjen Vetëvendosje, e cila në këto zgjedhje fitoi në katër komuna dhe humbi në dy qytetet më të mëdha - Prishtinë dhe Prizren. PDK-ja në zgjedhjet lokale fitoi tetë, po ashtu edhe LDK-ja tetë komuna. Ndërkaq AAK-ja doli e treta nga partitë shqiptare duke fituar në pesë komuna gjithsej.

Kosova dhe ‘Ballkani i hapur’

Vendi ynë gjatë këtij viti që po lëmë pas refuzoi të bëhet pjesë e iniciativës “Ballkani i hapur”, që u hodh si ide nga kryeministri shqiptar Edi Rama, presidenti serb Aleksandër Vuçiq dhe tashmë ish-kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, fillimisht me emrin “mini-shëngeni” Ballkanik që, sipas tyre, synon



**EPOKA E RE**

Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com





vendosjen e lëvizjes së lirë për njerëzit, mallrat e shërbimet ndërmjet vendeve të rajonit. Pavarësisht se kësaj iniciative iu vë emri tjetër “Ballkani i hapur”, nuk e ndryshoi qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për t’iu bashkuar kësaj iniciative, e cila mori edhe përkrahjen e zëvendësndihmëssekretarit amerikan të shtetit, Gabriel Escobar. “Ballkani i hapur” nuk po pranohet edhe nga Mali i Zi dhe Bosnja. Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut në dhjetor të këtij viti kanë avancuar agjendën e iniciativës rajonale “Ballkani i hapur”. Në samitin e radhës të kësaj iniciative të mbajtur në Tiranë këto vende kanë nënshkruar disa marrëveshje që rritin bashkëpunimin mes tyre. Udhëheqësit e këtyre vendeve kanë ftuar edhe tri vendet e tjera të rajonit, Kosovën, Malin e Zi dhe Bosnjë Hercegovinën, që t’i bashkohen kësaj iniciative. “Çështja e mosdakordësisë ka dialogun e vet, ka rrugën e vet. Ama një gjë duhet ta dini, nëse të gjashtë vendet marrin pjesë, atëherë edhe për Kosovën edhe për Bosnjën do të jetë shumë më e mirë atmosfera për të trajtuar edhe çështje të tjera”, ka thënë kryeministri Edi Rama. Në takimin e Tiranës themeluesit e iniciativës “Ballkani i hapur” kanë nënshkruar pesë marrëveshje të reja të cilat pritet ta shtojnë bashkëpunimin në mes të këtyre vendeve.

## Pandemia Covid-19

Në vitin e dytë të përballjes me pandeminë Covid-19, Kosova shënoi dy periudha të vështira. Në muajin mars u regjistruan 21 mijë infektive dhe 273 vdekje. Vala e infektiveve kulmoi në muajin gusht, kur si asnjëherë më parë u raportuan 36 mijë e 461 raste të reja të të prekurve duke e bërë atë periudhën me më së shumti infektive që nga shfaqja e pandemisë në mesin e muajit mars të vitit 2020. Gjatë atij muaji 238 veta humbën jetën nga pasojat e sëmundjes. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se nga 1 gushti deri më 1 dhjetor të 2021-s, 1 435 qytetarë humbën jetën nga Covid-19. Prej këtyre, 1 280 (apo 89 për qind) ishin të pavaksinuar. Për ta mbrojtur veten dhe të tjerët, vaksinimi është shumë i nevojshëm, sidomos tani pas shfaqjes së variantit të ri “Omicron”. Së fundmi, MSh ka aprovuar edhe dhënien e dozës së tretë të vaksinës anti-Covid, me të cilën synohet të forcohet imuniteti i personave me sëmundje shoqëruese dhe atyre që janë vaksinuar më herët. Kosova mori 24 mijë dozat e para të vaksinës “AstraZeneca” përmes programit COVAX, në fund të muajit mars, duke u bërë vendi i fundit në Evropën Juglindore që nisi këtë proces. Në fund të majit Ministria e Shëndetësisë arriti një marrëveshje me kompaninë “Pfizer” për blerjen e mbi 1 milion e 200 mijë dozave të vaksinës kundër Covid-19. Në

fillim të shtatorit, Shtetet e Bashkuara i dhuruan Kosovës mbi 503 mijë doza të vaksinës “Pfizer”, që ishin pjesë e një blerjeje prej gjysmë miliardi të vaksinës “Pfizer” të siguruar nga presidenti Joe Biden në fillim të verës.

## Kriza energjetike

Opozita në Kosovë ka kritikuar qeverinë Kurti për qëndrime që nuk përkojnë me orientimin pro amerikan të vendit, pas vendimit të qeverisë për të mos çuar përpara një projekt për lidhjen me një gazsjellës ekzistues me Maqedoninë e Veriut, një projekt i propozuar nga korporata amerikane, Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC). Opozita ka insistuar në vazhdimësi që të mos hiqet dorë nga projekti. I zëshëm në këtë ishte ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. “Nuk e di se si do të vepronin në të ardhmen kryeministër edhe si do të kërkonte ju nga aleatët tanë mbështetje për energjinë, nëse pa asnjë argument pra keni hedhur poshtë gjithë këtë përpjekje edhe investim të kohës, kapaciteteve, resurseve humane, financiare për zgjidhjen ideale që na është ofruar, duke i njohur parashikimet për sigurinë energjetike për të ardhmen jo shumë të largët, pra për vështirësitë që do të ketë i gjithë rajoni”, ka thënë Haradinaj. E shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, i është drejtuar Kurtit me këto fjalë: “Refuzimin e këtij projekti nuk

kanë me ta falë qytetarët, pra sot po ua bëni dëmin më të madh të mundshëm qytetarëve, gjeneratave të ardhshme me pozicionin politik çfarë e ke marrë karshi këtij projekti tepër të rëndësishëm. Edhe një herë po them, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk ka pasur projekt më të rëndësishëm për sigurinë dhe ekonominë tonë”. Por Kurti për të dy, Haradinajn dhe Tahirin, pati një përgjigje: “Nuk është as aleanca as partneriteti i ShBA-së, as ai i sigurisë kombëtare e i mbrojtjes së shtetit, në njërin anë dhe as ai ekonomik e zhvillimor në anën tjetër, i varur për një pe. Nuk qëndron aleanca dhe partneriteti ynë i varur në perin që tash mund të shkëputet shumë shpejt, prandaj unë ju lus të gjithëve që të keni më shumë besim në aleancën dhe partneritetin me ShBA-në, sepse ky besim i juaji u ndihmon të gjithëve, por nuk mund të lëkunden aleanca dhe partneriteti i tillë sepse tash veç sa është forcuar me qasjen tonë parimore dhe me planet tona afatmesme dhe afatgjata”, pati deklaruar kryeministri Kurti. E pas kësaj, në muajin dhjetor filloi kriza energjetike në vend. Nisën reduktimet e ndërprerjes së saj. Kjo gjendje ngjalli reagime të shumta të qytetarëve në rrjetet sociale. Qeveria ndau 20 milionë euro për importin e energjisë elektrike, me qëllim të subvencionimit të konsumit, sigurimit të furnizimit stabil për qytetarët dhe të evitimit të rritjes së çmimit të energjisë.

“Së bashku do ta tejkalojmë edhe këtë krizë të madhe të energjisë nëpër të cilën muajt e fundit po kalojnë të gjitha vendet e regjionit dhe të Evropës”, tha kryeministri Kurti. Kuvendi i Kosovës më 29 dhjetor ka miratuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për masa emergjente për furnizimin me energji elektrike. Me 57 vota për, 17 abstenime dhe asnjë kundër janë vendosur kufizimet për furnizim me energji për konsumatorët dhe për vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë. Një ditë më parë, më 28 dhjetor, në Kuvend është zhvilluar një debat i gjatë për këtë çështje dhe në fund nuk ka pasur kuorum për miratim. Deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë shprehur qëndrime të kundërta për këtë çështje. Sipas deputetëve të opozitës, ndërmarrja e këtyre masave është e vonshme. Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se sektori i energjisë në Kosovë është duke kaluar një nga sfidat më të mëdha që nga përfundimi i luftës. Fatura e energjisë elektrike në Kosovë mund të shtrenjtohet për 7 për qind në muajt e ardhshëm. Një rritje të tillë e ka kërkuar Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS). Kosova në vitin e ri 2022 po hyn me probleme në sektorin e energjisë elektrike, me shpresën se edhe për këtë problem do të gjendet zgjidhje.





# PADREJTËSIA SPECIALE

Ish-drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë. Është bërë më shumë se një vit që nga koha kur ata janë në Hagë. Gjatë vitit 2021 janë mbajtur disa konferenca për ecurinë e çështjes ndaj tyre. Gjatë këtyre konferencave janë zhvilluar përplasje të ashpra në mes të avokatëve të ish-liderëve të UÇK-së dhe prokurorëve të Gjykatës Speciale. Madje avokatët e kanë akuzuar Gjykatën Speciale se është duke i mbajtur padrejtësisht liderët e UÇK-së

**EPOKA E RE**

**Lirim GEÇI**

**PRISHTINË, DHJETOR/ JANAR** - Është bërë më shumë se një vit që kur ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë paraburgosur në Hagë pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale. Më 5 nëntor të 2020-s Dhomat e Specializuara kishin konfirmuar aktakuzën ndaj

ish-krerëve të UÇK-së dhe ish-inftuar të paraqiten në gjykatë. Thaçi, Veseli dhe Selimi, pas marrjes së ftesës, vullnetarisht kishin udhëtuar për në Hagë. Në paraqitjen e tyre të parë para trupit gjykues, ata janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Deri më tani janë mbajtur disa konferenca statutore me qëllim të organizimit të shkëmbimeve ndërmjet palëve. Fillimisht në këto

seanca ish-komandantëve të UÇK-së u është lexuar aktakuza, ku ata kanë hedhur poshtë pretendimet e prokurorisë. Konferencat statutore janë karakterizuar me përplasje të avokatëve me përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorisë së Specializuar. Pala mbrojtëse e ka akuzuar vazhdimisht prokurorinë për zvarritje të qëllimshme të procesit dhe mosdorëzim të dosjes paraprake. Kur ka kaluar më shumë se një vit, prokuroria ka dorëzuar dosjen paraprake në

rastin ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u akuzuar për krime lufte nga Gjykata Speciale.

**Avokatët mbrojtës:  
Themelet e Speciales  
janë të mbështetura në  
gënjeshtër**

Akuzat më të ashpra të avokatëve ndaj kësaj gjykate janë thënë në seancën për ecurinë e çështjes, e cila është mbajtur më 29 tetor të vitit 2021. Në këtë seancë avokatët e ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë thënë se themelet e Gjykatës Speciale janë mbështetura mbi gënjeshtër. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka shpërthyer në akuzat ndaj prokurorisë, duke theksuar se Specialja u ndërtua

mbi themelet e një raporti (te Dick Marty) që është krejtësisht gënjeshtër. Sipas tij, gjithë kjo vonesë po bëhet qëllimshëm që krerët e UÇK-së të mbahen në paraburgim. "Ky është një proces i qëllimshëm që këta burra të rrinë në paraburgim. Ne nuk e dimë se kur do të fillojnë hetimet e tyre. Institucioni u themelua për t'i shqyrtuar këto akuzat absurde të cilat ishin të rreme. E dimë që u sajuan nga dëshmitarë të cilët i ka paraqitur zbulimi i fshehtë serb. Prokuroria nuk ka gjetur asnjë provë mbështetëse për akuzat e saj. Themelet për ngritjen e këtij tribunali kanë qenë të mbështetura në gënjeshtër. Dick Marty shkroi një raport që përfshinte akuzat më absurde për UÇK-në", ka thënë ai. Emmerson ka theksuar se ish-krerët e UÇK-së nuk kanë bërë asgjë, por vetëm kanë qenë





politikanë të suksesshëm. Ai ka thënë se e sheh të pamundur që gjykimi ndaj komandantëve të UÇK-së të fillojë para fundvitit të vitit 2022. “Nuk mendoj, dhe duket absolutisht e pamundur që gjykimi të fillojë para fundvitit të 2022-s”, ka thënë Emmerson.

Akuzat ndaj Prokurorisë së Specializuar të Hagës i ka vazhduar edhe avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe. Ai ka thënë se prokuroria po bën veprime që shkojnë në dëm të krerëve të UÇK-së.

Avokati Gregory Keohe e quajti “qesharake” qasjen e prokurorisë duke vënë në dukje se prokuroria në fillim pretendonte se gjykimi të niste në verën e vitit 2021. “Është shokuese për mua pozicioni i ZPS-së. Jam i sigurt që edhe ju zoti gjykatës jeni mërziur nga kjo. Klientët tanë janë burgosur që nga viti i kaluar. Avokati koleg sapo na tha që afati fillestar ishte maji. E kuptoj zoti gjykatës që e keni shtyrë. Çfarë ka ndodhur? Që nga konferenca e parë në kemi marrë 1 732 dokumente teksta mbrëmë kemi marrë mbi 200 dokumente. Jam dakord me Roberts. Kur do t'i vijë fundi kësaj çështjeje? Tani na kërkohet që afati të shtyhet deri më 31 janar. Flitej që gjykimi do të fillonte në këtë vit, teksta tani dëgjojmë këtë kërkesë për shtyrje. Klienti im është në burg. Kjo është qesharake. Duhet të ketë një pikë dalëse. Ata kanë vendosur që t'i ndalojnë këta burra”, ka thënë avokati Keohe.

Edhe avokati tjetër mbrojtës i Hashim Thaçit, Roberts, ka theksuar se kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj që nga koha e afatit fillestar për nxjerrjen e materialeve. “Sa herë vijmë këtu prokuroria kërkon zgjatjen e afateve kohore. Po ecim përpara, por me ritëm shumë të ngadaltë. Jam i shokuar me efikasitetin e ZPS-së. Mendoj se edhe ju jeni i shokuar. Po flasin për zgjatjen e afateve, ndërkohë që klientët tanë janë të burgosur. Si mund të thotë një njeri me mendje të plotë, që po bëjnë çdo gjë për të akuzuarit, ndërkohë që vazhdojnë e vazhdojnë me dokumentet e të akuzuarve tanë që po mbahen në burg. Kjo është qesharake. Duhet të ketë një pikë ndarëse. Ata kanë vendosur t'i ndalojnë këta burra. Më 31 janar thonë se do t'i marrin dokumentet dhe me siguri atëherë do të marrin kërkesë për shtyrjen e tyre deri në mars”, ka thënë ai. Edhe avokati i Rexhep Selimit e ka kritikuar prokurorinë për zvarritjen e procesit të nxjerrës së materialeve.

Ai ka thënë se sa më shumë që po afrohen të materialet aq më shumë po zgjatet procesi. Më tutje, ai ka thënë se deri më tani nuk është shënuar asnjë përparim në këtë proces. “I nderuar gjykatës, unë vetë nuk jam vrapues, por nga ana tjetër e shoh që sa më shumë të lëvizim aq më shumë na largohet pika e arritjes. Nga ana ime, pa u futur në hollësi për materialet, mund të them se nuk kemi bërë asnjë lloj progresi. Jemi tërësisht në të njëjtën situatë dhe na u kërkua sërish që afati kohor të shtyhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm”, ka

thënë avokati i Rexhep Selimit. Kujtojmë se avokati i Thaçit, ai i Veselit, i Selimit dhe i Krasniqit disa herë gjatë vitit 2021 kanë kërkuar Gjykata Speciale që klientët e tyre të mbrohen në liri, por një gjë e tillë është refuzuar në vazhdimësi. Në këtë drejtim avokatët kanë ofruar edhe garanci për klientët e tyre, por një gjë e tillë është refuzuar. Madje Gjykata Speciale nuk i ka marrë parasysh as garancitë që ka ofruar edhe Policia e Kosovës. Gjatë muajit shtator të vitit 2021 një delegacion i Ministrisë së Drejtësisë ka vizituar të paraburgosurit në Hagë. Këtë delegacion kishin refuzuar ta takonin Thaçi dhe Veseli. Krahas këtyre vizitave, gjatë vitit 2021 janë lejuar edhe vizitat familjare dhe të miqve të ish-liderëve të UÇK-së.

### **Për çfarë akuzohen ish-krerët e UÇK-së?**

Ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, rëndojnë akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi dyshohen për veprat penale që kanë të bëjnë me krime lufte: ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit: burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999. Krimet pretendohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës dhe në veri të Shqipërisë, përkatësisht në Kukës dhe Cahan. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty.

### **Vazhdon gjykimi ndaj Mustafës, Gucatit dhe Haradinajt**

Krahas Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, në Hagë janë duke u mbajtur në paraburgim edhe ish-eporri i UÇK-së, Sali Mustafa, i njohur si “Calit”, drejtuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, si dhe ish-eporri Pjetër Shala. Ndaj “Calit”, Gucatit dhe Haradinajt tashmë ka filluar procesi gjyqësor ku janë mbajtur disa seanca si dhe janë dëgjuar disa dëshmitarë. Në fillim të këtyre seancave avokatët mbrojtës, por edhe të akuzuarit, kanë hedhur

poshtë të gjitha aktakuzat me të cilat ngarkohen nga ZPS-ja. Në seancën e 8 nëntorit të vitit 2021, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj para trupit gjykues kanë kritikuar këtë gjykatë, duke thënë se Specialja është mbështetur në dokumente të ofruara nga Qeveria e Serbisë dhe procesin ndaj tyre e kanë vlerësuar të padrejtë. Gucati dhe Haradinaj kanë theksuar se Gjykata Speciale nuk ka asnjë argument kundër tyre. I pari që iu ka drejtuar gjykatës ka qenë kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati. Fillimisht ai ka treguar historinë e fshatit të tij të lindjes, Morinë e Skenderajt, duke thënë se ky vend gjatë luftës së fundit ka humbur më së shumti njerëz për kokë banori.

Ai ka deklaruar se gjatë viteve 1998-1999 së bashku me babanë i janë bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t'i mbrojtur të drejtat elementare të njeriut, siç janë liria dhe e drejta për një jetë të lirë në vatrën tonë. “Në luftimet e qershorit të vitit 1999 unë jam plagosur nga forcat serbe dhe si pasojë e asaj sot jam invalid dhe nuk mund të ec si të gjithë njerëzit e tjerë. Ne si popull më i vjetër në Ballkan nuk e kemi pushtuar Serbinë, por vendi ynë ka qenë i pushtuar nga Serbia. Këtu jemi duke qëndruar padrejtësisht më shumë se një vit. Ne nuk kemi bërë asnjë mëkat”, ka deklaruar Gucati.

Ai ka përmendur masakrat që forcat serbe kanë kryer gjatë luftës në Kosovë. “Kemi shfrytëzuar të drejtën tonë të fjalës së lirë, të mendimit e të shprehjes së lirë. Të drejtën e fituar me sakrificë njerëzore e jonjerëzore. Vetëm gjatë marsit, prillit, majit e qershorit të vitit 1999 në popullin tonë janë kryer mbi 450 masakra e krime të gjenocidit serb. Pa i përmendur ato të viteve '90. Gjatë luftës së fundit në Kosovë janë vrarë mbi 1 400 fëmijë e dhunuar mbi 20 mijë gra. Janë vrarë mijëra pleq, të mbetur e të palëvizshëm, që nuk kanë mundur të largohen nga shtëpitë. As sot e kësaj dite nuk dimë asgjë për fatin e mbi 1 600 njerëzve të zhdukur. Pa folur këtu për shkatërrimet e

shkaktuara nga makineria serbe”, është shprehur ai, duke shtuar se është e drejtë e tij t'i mbrojtë vlerat kombëtare. “Është e drejtë legjitime e imja t'i mbrojtë drejtat dhe vlerat e kombit tim. Të drejtat dhe vlerat e UÇK-së dhe të republikës së shtetit tim të Kosovës. Jam i obliguar t'i mbrojtë drejtat e liritë e popullit për jetë më të mirë e më të begatë, si gjithë popujt e kontinentit tonë”, ka thënë Gucati.

Kurse nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, ka deklaruar se Zyra e Prokurorisë së Specializuar është e përkrahur nga Qeveria e Serbisë. Ai ka thënë se prokuroria është duke e trajtuar atë me përbuzje. “Kjo prokurori po e dëshmon atë që e kam thënë unë me OVL-në. Kushdo që ka kryer krim, nuk meriton aspak dhe duhet të përballet me drejtësinë. Prokurori Jack Smith qëndroi para jush dhe tha 'kjo s'ka të bëjë me UÇK-në'. Kjo është gënjeshtëri. Është pikërisht e kundërta. Kjo prokurori po e falënderon Qeverinë e Serbisë për mbështetjen e dhënë”, ka deklaruar Haradinaj. Ai ka thënë se prokuroria nuk e ka asnjë provë ndaj tij. “Prokuroria nuk e meriton që unë të jem këtu, që t'jua bëj dekorin. Vendosa të vij këtu të them të vërtetën. Veprimet e kësaj prokurorie dëshmojnë se jam këtu prej 14 muajsh, kur asnjë provë nuk mund t'i mbështesë akuzat qesharake”, ka deklaruar ai. Haradinaj i ka bërë thirrje trupit gjykues që ta përfundojë këtë çështje. “Të nderuar anëtarë të panelit, gjykatës dhe ju përfaqësues të shtetit tim që jeni sot aty dhe më dëgjoni, këto komente të shkurtra i bëj si qytetar krenar i Republikës së Kosovës, që i është nënshtruar një procesi nga Prokuroria që mund të cilësohet vetëm si e padrejtë dhe selektiv. Tani ju bëj thirrje, të nderuar gjyqtarë, të një institucioni kombëtar të vendit tim të lindjes, ta përfundoni këtë çështje”, ka thënë Haradinaj.

Para se Zyra e Prokurorit të Specializuar ta mbyllë zyrtarisht çështjen, avokatët e Gucatit dhe

Haradinajt kanë lënë të hapur mundësinë për të sjellë dëshmitarë.

Jonathan Elystan Rees, avokat i Hysni Gucatit, ka thënë se kanë disa dëshmitarë. “Provat e ZPS-së ose çështja e ZPS-së, përpara mbylljes, duhet të përfshijë jo vetëm mundësinë për pyetje të plotë të këtyre tre dëshmitarëve të mbrojtjes, por ZPS-ja duhet të thërrasë, qoftë edhe për të paraqitur si dëshmitar të çështjes së tyre një person që është i aftë të dëshmojë për hetimin që ata kanë kryer lidhur me akuzat për shtyrje për vepër penale”, ka thënë ai.

Edhe Toby Cadman, avokat i Nasim Haradinajt, ka thënë se me mbrojtjen e Gucatit e kanë një listë të përbashkët të dëshmitarëve. “Synimi ynë në këtë fazë është që edhe z. Haradinaj të thirret për të dhënë dëshmi, por shumë nga kjo varet se çfarë do të ndodhë këtu. Lista aktuale e dëshmitarëve, sipas vendimit tuaj, do të varet nga rezultati i disa çështjeve, por ne do të bëjmë çmos t'u ndihmojmë sa më shumë të jetë e mundur. Kemi një listë të përbashkët dhe nuk do të përsëritim dëshmitarët, pra ose njëri ose tjetri do ta thërrasë dëshmitarin që do të mund t'u shërbejë interesave të të dyve për ta ndihmuar gjykatën në këtë mënyrë. Por, megjithatë, ka disa çështje që duhen zgjidhur, kështu që është e pamundur të themi më shumë se kaq”, ka thënë Codman. Në gjykimin ndaj krerëve të OVLUÇK-së deri tani janë dëgjuar disa dëshmitarë të ZPS-së dhe mbrojtjes. Gjykimi ndaj Gucatit dhe Haradinajt ka filluar më 7 tetor të këtij viti. Veprat penale që rëndojnë ndaj Gucatit dhe Haradinajt, sipas Dhomave të Specializuara, janë se janë kryer në periudhën 7-25 shtator 2020. Që të dy janë arrestuar më 25 shtator në Prishtinë dhe që atëherë gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë. OVLUÇK-ja në shtatorin e kaluar ka pranuar, në mënyrë anonime, dosje që lidhen me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Përmbajtja e këtyre dosjeve nuk është bërë e njohur dhe nuk është konfirmuar nëse ato janë autentike apo jo.





# Synimet e FSK-së, ushtri moderne dhe anëtare e NATO-s

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Kanë kaluar rreth tre vjet që kur institucionet e Kosovës bënë hapin përpara me vendimin për procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga një mandat për mbrojtje civile e reagim emergjent në forcë mbrojtëse ushtarake. Kjo lëvizje nga udhëheqësia e Kosovës, e nxitur nga mbështetja masive e publikut, u pa me skepticizëm nga disa prej aleatëve tradicionalë të vendit, që kishin frikë se vendimi do të çonte në jostabilitet.

Disa madje mund të pohojnë se, në fakt, procesi i tranzicionit të mandatit të FSK-së e ka ndihmuar kohezionin shoqëror në Kosovë dhe, si i tillë, e ka forcuar stabilitetin e vendit. Me fjalë të tjera, diskursi shqetësues për tranzicionin e FSK-së u tregua i pabazuar dhe vendimi deri më sot ka dëshmuar më shumë përfitime sesa që pritej.

Procesi i tranzicionit të mandatit të FSK-së po ecën përpara sipas planit. Ministria e Mbrojtjes (MM) duket se po ndjek me rigorozitet procesin e tranzicionit siç përcaktohet në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit për ndërtimin e aftësive mbrojtëse.

Që nga viti 2018 FSK-ja shtoi përpjekjet e veta për të shërbyer si forcë 'me qëllime të mira' si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Në zhvillimin e fundit ajo dha kontribut të prekshëm gjatë katastrofës së tërmetit në Shqipëri

në nëntor 2019 dhe zbarkoi misionin e parë jashtë shtetit në Kuvajt si pjesë e kontingjentit amerikan IOWA në mars 2021.

Tranzicioni i FSK-së nuk u shndërrua në ndonjë përshkallëzim marrëdhëniesh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe

jashtë vendit. Sfidat e saj në zhvillim janë më shumë si rrjedhojë e problemeve të brendshme strukturore sesa ato të karakterit politik.

Forca e Sigurisë së Kosovës edhe në këtë vit që po lëmë pas doli të jetë institucioni më i besueshëm i



trajektorja e zhvillimit të saj deri më tani nuk kontribuoi në narrativën destruktive në marrëdhëniet midis dy vendeve; Skeptikët e tranzicionit të FSK-së janë dobësuar, ndërsa ata që mbështetnin mandatin e ri janë fuqizuar.

Deri më tani tranzicioni i FSK-së konstaton se zhvillimi i kësaj force është duke ndodhur sipas dinamikës së paraparë. FSK-ja është në vazhden e validimit të kapaciteteve këmbësorike grupore me qëllim të ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial dhe kontributit në misionet e paqes

sigurisë në vend për qytetarët e Kosovës, me nivel edhe më të lartë se në vitet e tjera, me 82 për qind të besueshmërisë qytetare.

Në dhjetor ushtrisë sonë iu shtuan edhe 190 ushtarë të rinj profesionistë.

Qeveria e Kosovës këtë vit ka miratuar Projektligjin për Policinë Ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ky projektligj përcakton misionin, organizimin, autorizimin dhe detyrat e Policisë Ushtarake të FSK-së. Është hera e parë që misioni dhe statusi i Policisë së FSK-së rregullohet me ligj të veçantë.

“Duke marrë parasysh faktin që synimi i Kosovës është anëtarësimi në NATO, rregullimi i misionit të Policisë Ushtarake është një hap i rëndësishëm drejtë këtij synimi”, ka thënë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.

Ai ka thënë se rritja e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet vendeve të Evropës Qendrore dhe vendeve mbështetëse drejt anëtarësimit në BE dhe NATO është gjithmonë e nevojshme dhe e mirëseardhur. “Vizioni i Republikës së Kosovës është ta promovojë stabilitetin dhe sigurinë, jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për rajonin, Evropën dhe më gjerë. Forca e Sigurisë së Kosovës është ndërtuar me mbështetjen e partnerëve të NATO-s si forcë profesionale multietnike në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj”, ka deklaruar ministri Mehaj.

FSK-ja për vitin 2022 do të ketë në

dispozicion 100 milionë euro. Gjithashtu në këtë vit që po lëmë Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit.

Ndërsa Kosova në gusht të këtij viti ka marrë donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës 50 mjete ushtarake të blinduara. Në muajin korrik, po të këtij viti, Qeveria e Kosovës kishte ndarë 4.5 milionë euro shtesë për Ministrinë e Mbrojtjes për blerje të dronëve. Kurse në qershor, po ashtu të vitit 2021, Ushtria e Kosovës është pajisur me disa autobllinda, gjithashtu donacion nga Amerika. Nipi i komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, Bashkim Jashari, është komandant i ri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). FSK-ja aktualisht numëron 2 500 pjesëtarë të rregullt dhe 800 rezervistë. Me mandatin e ri parashihet që të ketë 5 000 ushtarë aktivë dhe 3 000 pjesëtarë rezervë.







Në vitin 2021 u shfaq fantazma e Esat Pashë Toptanit me Pashiqin dhe e Enver Hoxhës me Titon, në një version më të modifikuar, por esencialisht të njëjtë. Prandaj në planin kombëtar kjo ngjarje, e emërtuar si “Ballkani i Hapur”, (Pashiqi e pati emërtuar “Ballkani ballkanasve”), do të mbetet njollë dhe me pasoja të rënda. Jo për mënyrën e reagimit nga Kosova, po për lehtësinë me të cilën Shqipëria e Edi Ramës e ka injoruar historinë e vet të hidhur me Serbinë e me Jugosllavinë

Milazim KRASNIQI

# VITI 2021 ISHTE VIT I POLITIKAVE JOKOMBËTARE DHE I PSEUDOSHKENCES ALBANOLOGJIKE

Malit i është bërë shprehi të më kërkohet një tekst për numrin festiv të gazetës “Epoka e re” dhe unë gjithnjë ia konfirmoj se do ta shkruaj, (me kësmtet.) Përveç respektit për gjithë ekipin e këtij mediumi, gjithnjë e kam edhe shpresën ose iluzionin se “Epoka e re” do të rikthehet si gazetë ditore dhe do ta shpëtoj nga turpi tregun tonë medial, i cili sot për sot nuk e ka asnjë gazetë ditore. “Epoka e re” ka qenë ndër vite një gazetë e bujshme, optimiste, shprehje e triumfalizmit postçlirimtar, ose siç thuhej në prezantimin promocijal televiziv, “gazeta më e guximshme shqiptare.” Pra, edhe pse po shkruaj prishaqejfas për një medie on lajn, po kam dëshirë ta ruaj iluzionin se po shkruaj për gazetë ditore.

Gjej rastin të them se po të ishin këta kapitalistët e rinj të vendit tonë të prerë me stof kombëtar, do të ishin donatorë bujarë të kësaj gazete, e cila ka dhënë dëshmi se është një bastion i shqiptarizmit. Fatkeqësisht, deri sot nuk ka funksionuar asgjë në atë drejtim, sepse ata japin para për emisione limonada e jo për medie me përmbajtje kombëtare. Sidoqoftë, ky tekst do të jetë në pajtim me sloganin, “gazeta më e guximshme shqiptare”, pra, duke e aktualizuar shqiptarësinë si problem gjatë vitit që mbaron, vitit 2021.

Shqiptarësia gjatë këtij viti ka marrë një krisje të fortë, me iniciativën “Ballkani i Hapur.” Me këtë iniciativë na ka ndodhur ajo që dikur nuk mund të na fanitej as edhe në ëndërr: një konfrontim i hapur ndërmjet politikës shtetërore të Shqipërisë dhe Kosovës. Qeveria Rama 3, ka avancuar shumë gjatë këtij viti në bashkëpunimin me

Serbinë. Takimi i fundit për këtë vit u mbajt në Tiranë më 21 dhjetor dhe u mbyll me disa marrëveshje të çuditshme, për ata që kanë kujtesë kombëtare. Pra, krijimi i tregut të përbashkët ndërmjet Serbisë, Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut, na kujton saktësisht marrëveshjen e Esat Pashë Toptanit me Serbinë në vitin 1914, kur ai pati firmosur marrëveshje me disa elemente bukur të ngjashme. Edhe Toptani pati firmosur që të ndërtohej hekurudha deri në Durrës, por edhe bashkimi doganor i dy vendeve. Marrëveshjet e tashme në kuadër të “Ballkanit të Hapur” nuk kanë komponentën politike si marrëveshja ndërmjet Toptanit e Pashiqit, por komponenta ekonomike po shkon në të njëjtin drejtim. Sigurisht është e modifikuar, për realitetet e reja shtetërore (Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe nuk mund të luajë me sigurinë kolektive të NATO-s.) Për të qenë kjo linjë e bashkëpunimit ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë edhe më absurde, po i kujtoj edhe marrëveshjet e Enver Hoxhës me regjimin komunist jugosllav, që ishin brenda këtyre linjave, edhe ato me synimin final bashkimit doganor ndërmjet dy shteteve. Pra, në vitin 2021, u shfaq fantazma e Esat Pashë Toptanit me Pashiqin dhe e Enver Hoxhës me Titon, në një version më të modifikuar, por esencialisht të njëjtë. Prandaj në planin kombëtar kjo ngjarje, e emërtuar si “Ballkani i Hapur”, (Pashiqi e pati emërtuar “Ballkani ballkanasve”), do të mbetet njollë dhe me pasoja të rënda. Jo për mënyrën e reagimit nga Kosova, po për lehtësinë e papërbalueshme me të cilën Shqipëria e Edi Ramës e ka injoruar

historinë e vet të hidhur me Serbinë e me Jugosllavinë. E ka injoruar brutalisht atë pretendim të hershëm serb e jugosllav për ta dominuar Shqipërinë, për të dalë në Durrës, për ta pushtuar ose copëtuar Shqipërinë. Kjo harresë është më e pafalshme se sa dëmi që i është bërë Kosovës me këtë iniciativë bizare.

E dyta, qeveria e Albin Kurtit gjatë mandatit të parë, po edhe të këtij që e ka në vijim, ka përkeqësuar pozitën kombëtare e ndërkombëtare të Kosovës. Krijimi me presion propagandistik e politik i rrethanave që kompania amerikane “Contour Global” të largohet nga Kosova, duke e lënë vetëm në letër projektin për termocentralin “Kosova e re”, ka krijuar jo vetëm keqkuptime me një kompani amerikane po edhe katastrofë energjetike në vend. Këtë fundviti Kosova është e shfytëruar, e shkalluar nga katastrofa energjetike. Por qeveria Kurti 2 ka refuzuar edhe projektin tjetër amerikan, atë të gazsjellësit nga Maqedonia e Veriut. Kur t’i shtohet kësaj politike të çuditshme edhe fakti se qeveritarët, madje edhe presidentja e vendit, shprehen kundër “Marrëveshjes së Uashingtonit” të shtatorit 2020, bëhet e qartë se linja e politikës shtetërore gjatë vitit 2021 esencialisht është antiamerikane. Jo e deklaruar, por e përmbatur. Ka rrezik që pasojat e këtij kursi tinarz do të ashpërsohen në vitin 2022.

E treta, bota albanologjike gjatë vitit 2021 vetëm sa e ka thelluar mjerimin e vet. Mungesa e projekteve albanologjike në Shqipëri e në Kosovë, tashmë e ka sjellë marginalizimin e

albanologjisë dhe të albanologëve. Sot albanologjia nuk ka ndonjë ndikim më medimin kulturor, politik e kombëtar shqiptar. Këtë mendim e dizajnon/dhunon ndonjë piktor sharlatan, si Rama, ndonjë inxhinier, që aktron filozofin e antikës, si Kurti, ndonjë juriste mediokre si Vjosa Osmani dhe njerëz të organizatave joqeveritare e profiterë të ndryshëm.

Mjafton të shihet programi i “Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, 24-28 nëntor 2021, për të kuptuar krizën dhe mjerimin e albanologjisë (edhe) gjatë këtij viti. Me dhjetëra tema që janë trajtuar me dhjetëra herë, me dhjetëra tema krejtësisht të parëndësishme, me një prirje që studimi shkencor të paraqitet si një ndërmarrje kooperativiste, e zbulojnë paditurinë e drejtuesve të dy akademive të shkencave dhe të spektrit të tërë albanologjik, në Shqipëri e në Kosovë. Ja disa tituj temash për betër: “Prokliza binare dhe enkliza shquese: dy anë të të njëjtut proces evolutiv tipologjik të gjuhës shqipe” “Mos ki merak, patriot”, “Kur nisi formësimi i teatrit (1920-1939)”, “Mbi prirjet e normës fonetike të shqipes së sotme”, “Shpërfaqja e formave në poetikën eksplicite të Kadaresë”, “Ngarkesa funksionale e trajtave të shkurtra në gjuhën shqipe.” Etj. Çka i flasin njeriut të sotëm shqiptar këso lloj temash? Çka i ofron njeriut të sotëm shqiptar, të rrëmbyer nga shtjella e globalizmit gllabërues, postmodernizmit dekonstruktues, konsumerizmit të shfrenuar, hedonizmit pervers, krizës klinike të identitetit, amnezisë historike? Asgjë. Ama bash asgjë.

E katërta, viti 2021 ishte i rëndë

shkaku i pandemisë. Askush nuk e ka ende të qartë se cilat janë pasojat e tashme dhe cilat janë pasojat afatgjate që do të stivojë pas vetes kjo pandemi, si në planin shëndetësor, moral po edhe në atë kombëtar. Jo vetëm që nuk e di askush, por askush nuk është duke kërkuar përgjigjet e mundshme, sepse nuk ka asnjë projekt shkencor në këtë drejtim. Projektet shkencore e pamë se në çfarë drejtimesh janë degëdisur. Edhe projektet ekonomike e politike me “Ballkanin e Hapur” dhe me antiamerikanizmin tinëzar, i pamë si po shpurdhin si larva. Prandaj viti 2021 ishte vit ters. Por, ka rrezik që do ta kërkojmë vitin 2021, ngase viti 2022 mund të jetë shumë më i rëndë. Problemet janë grumbulluar, ndërsa njeriut shqiptar në Kosovë e në Shqipëri i ka ardhur në majë të hundës, si politika jokombëtare, ashtu edhe pseudoshkenca albanologjike. Ka ardhur në pikën që ose do të rebelohet, ose do të shkombëtarizohet.

Në çdo fundviti, kur bëj një bilanc, më kujtohen tre vargjet e poetit italian Nelo Rizi: “Veç një gjë/Ngule mirë në kokë:/ Mos harro!” Ndoshta pikërisht pse jemi komb shumë harestarë, mua këto tre vargje nuk më shqiten nga mendja, si ftesë që të mbajmë mend, të mos harrojmë, sepse nëse harrojmë, nuk e dimë çka na ka ndodhë e ajo mund të na përsëritet. Jo vetëm në formën e pushtimit serb të Durrësit, po edhe në formën e atentatit ndaj Esat Pashës ose të vetëvrasjes së Naku Spirit. Thënë thjesht, dezertimi nga ideologjia dhe gjeopolitika kombëtare shqiptare, po edhe nga dija mirëfilli albanologjike, gjithmonë përfundon keq, më saktë përfundon tragjikisht.



# Ngjarjet më karakteristike në Kosovë në vitin 2021

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Viti 2021 ka qenë vit zgjedhor në Kosovë. Janë mbajtur dy palë zgjedhje, parlamentare dhe komunale. Në zgjedhjet parlamentare Lëvizja Vetëvendosje ka dalë fituese bindëse, duke marrë mbi 50 për qind të votave, ndërsa në ato lokale ka ndodhur ajo që shumë pak njerëz e kanë pritur. Në zgjedhjet e 17 tetorit dhe 14 nëntorit, Vetëvendosje ka arritur të fitojë në vetëm katër komuna. Suksesin më të madh në zgjedhjet lokale e kanë shënuar LDK-ja dhe PDK-ja duke fituar nga tetë komuna, e pasuar nga AAK-ja me pesë komuna. Krahas zgjedhjeve, në LDK dhe PDK kanë ndodhur ndryshime në lidhshpirtin e tyre. Lumir Abdixhiku është zgjedhur kryetar i LDK-së, ndërsa Memli Krasniqi kryetar i PDK-së. Po ashtu, në vitin 2021 kanë ndodhur edhe shumë ngjarje të tjera. Ballafaqimi me pandeminë ka qenë sfida kryesore, ku gjatë verës ka pasur një numër të madh të vdekjeve nga Covidi.

## Kushtetuesja shpall aktgjykimin për qeverinë Hoti

**6 janar** - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka publikuar aktgjykimin e plotë lidhur me votimin e Qeverisë së Kosovës, e udhëhequr nga Avdullah Hoti. Në këtë mënyrë është hapur rruga për caktimin e datës për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre nga presidenti. Në aktgjykimin prej 65-faqesh, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar rrëzimin e qeverisë Hoti, duke vlerësuar se vota e deputetit Item Arifi, që ishte i dënuar me vendim të prerë gjyqësor, ishte e pavlefshme.

## Osmani cakton datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

**6 janar** - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, me dekret presidencial ka caktuar 14 shkurtin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. "Duke u bazuar në përgjegjësitë kushtetuese dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KO-95/20, si dhe pas diskutimit me partitë parlamentare dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kam marrë vendim t'i shpall zgjedhjet dhe ta caktoj 14 shkurtin 2021 datë për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme. Me këtë vendim KQZ-ja është udhëzuar t'i ndërmarë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës", është



thënë në dekretin e Osmanit.

## Kurti dhe Osmani garojnë bashkë në zgjedhje

**14 janar** - Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani dhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, kanë nënshkruar të enjten listën e përbashkët për garën në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit në Kosovë. Sipas kësaj marrëveshje, Kurti do të jetë kandidat për kryeministër, ndërkaq Osmani kandidate për presidente të vendit. "Presidentja në detyrë dhe unë, ish-kryeministri, me subjektet tona politike do të na gjeni në të njëjtën vend dhe për të njëjtën qëllim. Kemi bërë marrëveshjen e parimeve dhe synimeve politike të cilën sapo e nënshkruam këtu para jush", ka deklaruar Kurti pas arritjes së kësaj marrëveshje, e cila është nënshkruar në ambientet e Kuvendit të Kosovës.

## Albin Kurtit dhe 46 kandidatëve u ndalohe të garojnë në zgjedhje

**20 janar** - Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konstatuar se 47 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 14 shkurtit nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. KGJK-ja dhe as KQZ-ja nuk kanë treguar emrat e kandidatëve, por

ofruar dorëheqje nga pozita e kryetarit të LDK-së. Mustafa ka thënë se rezultati i zgjedhjeve ka qenë shumë i keq për LDK-në. "Unë sot e kam njoftuar kryesinë se do ta thërras Kuvendin e LDK-së për zgjedhjen e kryetarit të ri në një periudhë të shpejtë kohore. Me statut e kemi 60 ditë që ta bëjmë këtë, mirëpo unë do ta bëj më shpejt", ka thënë Mustafa.

## Lumir Abdixhiku, kryetar i ri i LDK-së

**14 mars** - Kuvendi i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka zgjedhur të dielën Lumir Abdixhikun kryetar të ri të kësaj partie. Ai ka marrë 191 vota të 328 delegatëve të këtij Kuvendi. Në këtë garë me vota të fshehta, Abdixhiku e ka mposhtur nënkryetarin e LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka marrë 116 vota dhe anëtarin e kryesisë të kësaj partie, Besian Mustafa, i cili ka marrë vetëm 16 vota. Ndërsa kryetari i Degës së LDK-së në Prizren, Anton Quni, ka hequr dorë nga kandidatura e tij për kryetar pak para fillimit të Kuvendit Zgjedhor.

## Votohet "Qeveria Kurti 2"

**22 mars** - Ditën që janë betuar deputetët e legjislaturës së tetë kanë konstituuar Kuvendin, kanë zgjedhur kryeparlamentar Glauk Konjufcën dhe nënkryetarët e rinj. Pas marrjes së detyrës, kryeparlamentari i ri, njëherësh ushtrues i detyrës i presidentit, Konjufca, nëpërmjet një letre i ka kërkuar Lëvizjes Vetëvendosje propozimin e mandatarit për kryeministër. Më pas kryesia e Kuvendit ka thirrur seancën dhe në orët e mbrëmjes deputetët e koalicionit qeverisës kanë votuar qeverinë e drejtuar nga Albin Kurti.

## Vjosa Osmani zgjedhet presidente

**4 prill** - Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje nga Lista "Guxo", Vjosa Osmani Sadriu, është zgjedhur presidente e Kosovës. Osmani Sadriu u zgjodh presidente në raundin e tretë i cili ishte final për përcaktimin e presidentit të ri të vendit. Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë, ndërsa Osmani Sadriu ka marrë 71 vota për dhe 11 të pavlefshme, të nevojshme për kreun e shtetit. Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ia kanë bërë kuorumin Osmani Sadriut për t'u zgjedhur në postin e presidentes. Dymbëdhjetë deputetë të LDK-së kanë marrë pjesë në votim, duke përjashtuar tre deputetët: Agim Veliu, Avdullah Hoti dhe Driton Selmanaj të cilët nuk kanë marrë

pjesë në votim. Deputetët Adem Hoxha, Fadil Gashi, Adelina Grainca (PDK), e cila tashmë ka kaluar në grupin parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Albena Reshitaj (AAK), kanë qenë vendimtarë për zgjedhjen e Vjosa Osmanit presidente e Kosovës. Votimi i zgjedhjes së presidentit është bojkotuar nga Partia Demokratike e Kosovës, përjashto këtu deputeten Adelina Grainca, Listën Serbe, ndërsa nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë pjesë vetëm deputetja Albena Reshitaj.

## Petrit Ajeti emërohet drejtor i AKI-së

**15 prill** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë emëruar Petrit Ajetin drejtor të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Ajeti ka mbi 15 vjet përvojë pune në institucionet publike dhe private në fushën e sigurisë. Vetëm në gjashtë vjetet e fundit në AKI janë ndërruar tre drejtorë. I vetmi që ka përfunduar një mandat të plotë ka qenë drejtori i parë, Bashkim Smakaj, i cili ishte emëruar në këtë pozitë në shkurt të vitit 2009.

## Rama për herën e tretë fiton zgjedhjet në Shqipëri

**25 prill** - Partia Socialiste (PS) ka fituar për herën e tretë zgjedhjet parlamentare në Shqipëri. PS-ja në zgjedhjet e 25 prillit ka fituar 74 mandate. Partia Demokratike ka marrë 59 vende në kuvendin e ri krahasuar me 46 që ka pasur në vitin 2017, kurse Lëvizja Socialiste ka pësuar humbje, pasi ka arritur të marrë vetëm katër mandate nga 19 që ka pasur në zgjedhjet e kaluara.

## Sali Berishës dhe familjes së tij i ndalohe hyrja në ShBA

**19 maj** - Departamenti i Shtetit i ShBA-së ua ka ndaluar hyrjen në territorin amerikan ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha dhe anëtarëve të familjes së tij të ngushtë për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të gjerë. Në deklaratën e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, thuhet se Berisha, në cilësinë e tij zyrtare, në veçanti si kryeministër i Shqipërisë, ishte i përfshirë në veprime korruptive, të tilla si shpërdorim i fondeve publike dhe ndërhyrje në proceset publike. Sipas DASH-it, ish-kryeministri shqiptar ka përdorur pushtetin e tij për përfitime dhe për t'i pasuruar aleatët e tij politikë dhe anëtarët e familjes së tij.





Rrjedhimisht, u është ndaluar hyrja në ShBA: Berishës, bashkëshortes së tij, Liri Berisha, djalit të tij, Shkelzen Berisha dhe vajzës së tij, Argita Berisha Malltezi.

### Shkarkohen 12 ambasadorë

**20 maj** - Ministrija e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), Donika Gërvalla, ka liruar nga detyra 12 ambasadorë të emëruar mbi baza politike. Ajo ka thënë se një vendim i tillë përbën vetëm një hap në reformën e thellë që do t'i bëhet shërbimit diplomatik të Kosovës. Ambasadorët e shkarkuar janë: Beqë Cufaj - Gjermani, Nait Hasani - Shqipëri, Arbër Vllahu - Çeki, Lirim Grejçevci - Holandë, Shpend Kallaba - Hungari, Gezim Kasapolli - Kroaci, Avni Kastrati - Slloveni, Gjergj Dedaj - Maqedonia e Veriut, Hajdin Abazi - Australi, Ylber Hysa - Mali i Zi, Avni Arifi - Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Amir Ahmeti - Katar. Gjatë fundit të vitit 2021 MPJD-ja ka nisur emërimin e ambasadorëve të rinj në këto shtete.

### Osmani shkarkon Valdete Dakën

**14 qershor** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka shkarkuar të hënën Valdete Dakën nga pozita e kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në njoftimin e Presidencës theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i pavarur kushtetues dhe përgjegjësia për ta ruajtur pavarësinë e KQZ-së së pari është përgjegjësi e kryesuesit të Komisionit. Në vend të Dakës, Osmani ka emëruar Kreshnik Radoniqin.

### Kurti takohet me Vuçiqin

**15 qershor** - Takimi i parë ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka përfunduar pa ndonjë rezultat të martën në Bruksel. Udhëheqësit e të dy shteteve në këtë takim kanë paraqitur temat e tyre, duke mos u pajtuar për agjendën e dialogut të ardhshëm. Kryeministri Kurti ka thënë se në këtë takim ka paraqitur katër propozime të cilat nuk i janë marrë parasysh, ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës.

### Kurti takohet me Macronin në Paris

**23 qershor** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, është prituri në Pallatin Elysée nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Gjatë këtij takimi është biseduar për bashkëpunimin bilateral, përfshirë potencialin ekonomik

dhe hapësirën për kompanitë franceze për investime në Kosovë, me theks përfshirjen e mërgatës sonë. Po ashtu, ata kanë diskutuar edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe përparësitë e një qasje konstruktive nga të dyja palët.

### Memli Krasniqi zgjedhet kryetar i PDK-së

**4 korrik** - Memli Krasniqi është zgjedhur të shtunën kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Krasniqi është zgjedhur në këtë pozitë me shumicë votash të delegatëve pjesëmarrës në Konventën Zgjedhore të partisë. Në votim kanë marrë pjesë 476 delegatë. Vetëm shtatë ishin kundër. Në deklarimin e tij të parë pas marrjes së pozitës së kryetarit, Krasniqi ka thënë se do ta çojë përpara rrugën e trasuar nga ish-kryetari Hashim Thaçi e Kadri Veseli në krye të PDK-së. Krasniqi ka thënë se do të bashkëpunojë me secilin anëtar dhe qytetar që dëshiron t'i bashkohet PDK-së.

### Simmons jep dëshminë para deputetëve, nuk beson në Specialen

**12 korrik** - Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, ka drejtuar akuza të rënda ndaj Gjykatës Speciale dhe misioni EULEX. Në raportimin e tij para Komisionit për Legjislacion, ai Specialen e ka krahasuar me gjykatat në Rusi dhe Iran, duke thënë se nuk beson fare në drejtësinë e saj. Sipas tij, kjo gjykatë është njëetnike dhe synon t'i dënojë vetëm komandantët e UÇK-së. Misionin e EULEX-it ai e ka akuzuar edhe për korrupsion, joprofesionalizëm dhe ndikime politike. Para deputetëve, Simmons ka thënë se misioni i BE-së për sundim të ligjit synonte largimin e "peshqve të mëdhenj" nga skena politike.

### Rreth 1 500 qytetarë të Deçanit helmohen nga uji i pijshëm

**12 korrik** - Rreth 1 500 qytetarë të Deçanit kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në këtë komunë pas helmimit nga uji. Lajmin e ka dhënë kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, në një konferencë për medie. Ndërsa më 13 korrik komuna e Deçanit ka shpallur gjendje emergjente pas helmimit të mijëra qytetarëve.

### Humbin jetën tragjikisht 10 qytetarë të Kosovës në Kroaci

**24 korrik** - Dhjetë persona kanë vdekur dhe mbi 40 të tjerë janë lënduar të dielën pas daljes nga rruga të një autobusi me targa të Kosovës në autostradën afër Sllavovski Brodit në Kroaci. Në këtë autobus ishin 67 pasagjerë.

Me këtë rast, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shpallur një ditë zie shtetërore.

### Kosova vendos reciprocitet për targa me Serbinë

**20 shtator** - Kosova ka nisur aplikimin e masës së reciprocitetit për targa e automjeteve nga Serbia. Aplikimi i reciprocitetit ka bërë që të shkaktohen tensione në veriun e Kosovës, ku serbët atje kanë bllokuar rrugët magjistrale, duke penguar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave. Për disa ditë rrugët në veri kanë qenë të bllokuara, derisa Njësia Speciale e Policisë së Kosovës ka qëndruar në veri derisa është arritur marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë.

### Kosova dhe Serbia pajtohen për reciprocitet të targave

**30 shtator** - Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për shtensionimin e situatës në veri. Marrëveshja parashihet reciprocitet në targa në mes të dy shteteve, duke ua mbuluar simbolet shtetërore. Sipas dokumentit trepikësh, njësitet speciale policore të vendosura në pikëkalimet kufitare duhet të largohen bashkë me barrikadat. Qeveria e ka cilësuar fitore këtë marrëveshje, ndërsa opozita e ka kritikuar, duke thënë se qeveria e ka barazuar Policinë e Kosovës me barrikaduesit dhe ka dorëzuar sovranitetin te një palë e tretë. ShBA-ja dhe BE-ja e kanë mirëpritur marrëveshjen.

### Vitia jep dorëheqje nga pozita e ministrit dhe humbet garën për Prishtinën

**1 tetor 14 nëntor** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit për t'u përqendruar në garën për kryetar të Prishtinës. Këtë vendim ai ka thënë se e ka marrë në bashkërendim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe partinë e tij, Lëvizjen Vetëvendosje. Pavarësisht prej kësaj, ndonëse kishte dalë i pari në raundin e parë të zgjedhjeve (17 tetor) për kryetar të Prishtinës, ai ka humbur garën përballë Përparim Ramës së LDK-së më 14 nëntor. Pas zgjedhjeve në vend të Vitisë, Albin Kurti e ka emëruar Rifat Latifin, i cili është duke e drejtuar Ministrinë e Shëndetësisë.

### Opozita fiton zgjedhjet lokale

**17 tetor 14 nëntor** - Krahasuar me zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit, në zgjedhjet lokale Lëvizja Vetëvendosjes ka fituar më së paku komuna, vetëm katër sosh. PDK-ja dhe LDK-ja kanë fituar nga tetë komuna, AAK-ja pesë komuna dhe Nisma Socialdemokrate një komunë. Vetëvendosja ka fituar në: Gjilan,

Podujevë, Kamenicë dhe Shtime. PDK-ja ka fituar në: Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Skenderaj, Drenas, Vushtrri, Kaçanik dhe Han të Elezit. LDK-ja ka fituar në: Prishtinë, Pejë, Lipjan, Viti, Fushë Kosovë, Dragash, Istog dhe Junik. AAK-ja ka fituar në: Gjakovë, Rahovec, Suharekë, Deçan dhe Klinë. Nisma ka fituar në Malishevë. Në Obiliq ka fituar kandidati i pavarur Xhafer Gashi. Komunitet e tjera janë fituar nga minoritetet.

### 46 viktima në aksidentin tragjik në Bullgari, shumica e tyre shqiptarë

**23 nëntor** - Maqedonia e Veriut dhe shqiptarët janë tronditur të martën nga lajmi për vdekjen e 46 personave nga djegia e një autobusi në autostradën Struma të Bullgarisë. Mësohet se viktimat janë shqiptarë, ndërsa në mesin e tyre janë edhe 12 fëmijë. Autoritetet bullgare dhe maqedonase kanë bërë me dije se shkaqet e aksidentit janë duke u hetuar. Dyshimet e para janë se zjarri ka shpërthyer pasi autobusi ka goditur parrmakun mbrojtës të autostradës. Nga aksidenti kanë shpëtuar 7 persona, të cilët kanë arritur të largohen nga autobusi dhe gjendja e tyre është stabile. Për këtë aksident tragjik ka pasur reagime edhe nga liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilët janë shprehur të tronditur nga kjo ngjarje.

### Mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive shqiptare

**26 nëntor** - Kosova dhe Shqipëria kanë vendosur të heqin një numër pengesash në mes të dy vendeve. Në mbledhjen e shtatë të përbashkët të dy qeverive, këto dy vende kanë nënshkruar 13 marrëveshje të tjera të cilat do ta mundësojnë lehtësimin e procedurës për marrjen e lejeqëndrimit, rregullimin e regjimit të trafikut lokal të kufirit, lehtësira në procedura doganore, kalendar të përbashkët kulturor dhe njohje të diplomave. Kryeministrat e të dy vendeve, Edi Rama dhe Albin Kurti, janë zotuar se do t'i largojnë të gjitha pengesat në mes të dy vendeve. Ata kanë nënvizuar se sfidë e përbashkët është rritja e zbatimit të marrëveshjeve ndërmjet dy vendeve.

### Writen tre persona në Glogjan

**26 nëntor** - Tre persona, në mesin e tyre dy nxënës shkolle, kanë mbetur të vrarë nga të shtënat në drejtim të një autobusi në afërsi të fshatit Glogjan të komunës së Deçanit, rreth 100 kilometra larg Prishtinës. Motivi i të shtënave nuk është ende i qartë, por Policia e Kosovës ka thënë se nuk ka arsye për të besuar se incidenti është akt terrorist. Lidhur me këtë rast, më

11 dhjetor, policia ka arrestuar tre persona.

### Në krye të ushtrisë, nipi i Adem Jasharit

**30 nëntor** - Gjeneralmajor Bashkim Jashari është komandanti i ri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së). Emërimi i nipit të Adem Jasharit, komandantit legjendar të UÇK-së, në krye të ushtrisë së Kosovës, ka ardhur pas dorëheqjes të komandantit të deritashëm të FSK-së, Rrahman Rama. Ky i fundit nuk ka treguar për arsyen e dorëheqjes. Zyra e Presidencës ka bërë me dije se emërimi i komandantit të ri të FSK-së është bërë pas propozimit të ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe pas rekomandimit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

### Osmani merr pjesë në Samitin e Demokracisë

**9 dhjetor** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në Samitin e Demokracisë, i cili është organizuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden. Në këtë samit Osmani ka thënë se Kosova për një kohë të gjatë ka luftuar regjimet autoritare dhe gjencidiale. "Së shpejti Kosova do ta shënojë 14-vjetorin e pavarësisë, por regjimet autoritare dhe gjencidiale i kemi luftuar për një kohë shumë më të gjatë se kaq. Fillimisht, Kosova nuk ishte fituar në këtë samit, por më vonë i është bërë ftesa.

### ShBA-ja sanksionon kriminelët e veriut

**9 dhjetor** - Zyra e Kontrollit për Pasuritë e Huaja e Departamentit të Thesarit ka goditur grupin e biznesmenit serb Zvonko Veselinoviq, duke i vënë sanksione. Dhjetëra individë të këtij grupi akuzohen për marrëveshje me politikanët në veri të Kosovës për ta ndihmuar fitoren e tyre në zgjedhje dhe mbështetjen financiare për ta. Një veprim i tillë i ShBA-së është përshëndetur nga spektri politik i Kosovës. Institucionet e Kosovës kanë paralajmëruar se personat e sanksionuar do të hetohen edhe nga drejtësia vendore.

### Kuvendi miraton buxhetin e vitit 2022

**17 dhjetor** - Kuvendi i Republikës së Kosovës me 65 vota për ka miratuar buxhetin e shtetit për vitin 2022. Buxheti për vitin 2022 është 2 miliardë e 748 milionë euro. Sipas Qeverisë së Kosovës, ky buxhet siguron qëndrueshmëri të financave publike, ringjallje të ekonomisë dhe orientim drejt prodhimit vendor, përkrahje të punësimit, fuqizim të grave dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe rritje të mirëqenies qytetare.



# 10 ngjarjet më të rëndësishme gjatë vitit 2021

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Koronavirusi ka mbushur titujt e lajmeve gjatë 2021-s, megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk janë regjistruar ngjarje të paprecedentë në vitin e kaluar. Nga emetimet e dioksidit të karbonit deri te golat e Messit dhe Ronaldos, më poshtë janë 10 ngjarjet më të rëndësishme gjatë këtij viti.

## Rritja e dioksidit të karbonit për shkak të zjarreve

Zjarret që shpërthyen gjatë verës, veçanërisht në Amerikën e Veriut, shkaktuan emetime rekord të dioksidit të karbonit në korrik (1,258 metaton) dhe gusht (1 384.6 metaton) në shkallë globale, sipas Observatorit Evropian të Kopernikut, për shkak të ndryshimeve klimatike.

## Rritja e çmimit të gazit natyror

Një rimëkëmbje ekonomike më e fortë sesa pritej, kërkesa e fortë

në Azi dhe stoqet e ulëta evropiane të kombinuara në fillim të tetorit nxitën rritjen e çmimeve të gazit, duke arritur një nivel të paprecedentë prej 162 eurosh/MWh më 6 tetor.

## Tërheqja e trupave ushtarake nga Afganistani

Shtetet e Bashkuara tërheqën trupat ushtarake amerikane pas 20 vjetësh në Afganistan në gusht me një mbikalim gjigant që tejkaloi atë të Saigonit në fund të luftës së Vietnamit, por nuk ishte e mjaftueshme për t'i dëbuar të gjithë afganët që punonin për Perëndimin dhe të kërcënuar nga regjimi i talebanëve. Rreth 123 mijë afganë u larguan në krahasim me 55 mijë persona që u larguan nga Vietnami i jugut më 1975.

## Rritja e superfuqisë së Kinës

Në fillim të tetorit Kina kreu një sërë sulmesh ajrore ushtarake

(mbi 50) në hapësirën ajrore të Tajvanit brenda 48 orëve, duke riafirmuar superfuqinë e saj, dy javë pas shpalljes së një pakti ushtarak midis Australisë. Ndërkohë, Britania dhe ShBA-ja synojnë zgjerimin kinez në Paqësor.

## Blokimimi i kanalit të Suezit

Më 23 mars anija me kontejnerë Ever Given u bllokua në Kanalin e Suezit, duke bllokuar të gjitha rrugët e rëndësishme detare. Anija mbeti e bllokuar për gjashtë ditë, duke përkeqësuar vështirësitë e furnizimit që lidhen me pandeminë Covid-19.

## Bitcoin

Bitcoin arriti rekord në të lartë në nëntor (68.513 dollarë), një shenjë se investitorët po investojnë më shumë te kriptomonedhat, të cilat disa e shohin si një mënyrë për ta mbrojtur veten nga një rritje e mprehtë e inflacionit, i cili është rritur në tetor në ShBA në nivelin më të lartë gjatë 30 vjetëve të fundit.

## Të çmënduar pas artit

Çfarë kanë të përbashkët Frida Kahlo, Pierre Soulage dhe Banksy? Asnjë, përveç faktit se veprat e tyre fituan shuma shumë të larta në ankandet e këtij viti, siç është ky autoportreti i famshëm i artistit meksikan që u shit në nëntor në Nju-Jork për 34.9 milionë dollarë. Shumat me të cilat janë shitur veprat bashkëkohore të artit nuk kanë qenë kurrë kaq të larta (2.7 miliardë dollarë më 2020-2021).

## Turistët në hapësirë

Kapiteni Kirk, piloti i anijes kozmike Star Trek, i njohur si William Sutner, është një nga rreth 20 astronautët joprofesionistë që vizituan hapësirën gjatë vitit 2021. Aktori madje u bë, në moshën 90-vjeçare, personi më i vjetër që udhëtoi në hapësirë. Asnjëherë më parë lista e turistëve të hapësirës nuk ka qenë kaq e gjatë, me fluturime

nga kompanitë private të miliarderëve Jeff Bezos (Blue Origin), Elon Musk (Space X) dhe Richard Branson (Virgin Galactic).

## Ronaldo vs Messi

Dy legjendat e futbollit, portugezi Cristiano Ronaldo dhe argjentinasi Lionel Messi, fituan tituj nderi në shtator: Ronaldo u bë lojtari me më shumë gola në kombëtare (115 gola) dhe evropiani me më shumë paraqitje në kombëtare (184), ndërsa Messi kaloi brazilianin Pelé si golashënuesi më i mirë i kombëtares së Amerikës Latine (79 gola).

## Kanali Anglez dhe mali Everest

Kami Rita Serpa theu rekordin e tij për ngjitjen në Everest në moshën 51-vjeçare, ndërsa australiani Chloe McCardell, 36 vjeç, theu rekordin duke notuar Kanalin Anglez.







# Kriza energjetike në Kosovë: Pse jemi në këtë gjendje dhe cilat janë opsionet e daljes nga kriza?



Shkruan: Dr. sc.  
Ferat SHALA

Kosova gjatë muajve të fundit po përballlet me krizë energjetike e cila nuk ka qenë e tillë që nga viti 2010. Është fakt që një krizë e tillë energjetike po mbretëron edhe në Evropë dhe më gjerë, por kriza e Kosovës dallon shumë nga kriza globale energjetike.

Derisa në Evropë dhe më gjerë kriza energjetike ka zanafillën në çmimin e lartë të energjisë në tregun ndërkombëtar, në Kosovë kriza energjetike është e ndërlidhur me keqmenaxhimin, mungesën e vendimmarrjes së duhur institucionale, mungesën e planifikimit të qëndrueshëm dhe politikave të gabuara të qeverisjes aktuale.

Kriza energjetike në Kosovë është e ndërlidhur me mungesën e vizionit dhe qasjes totale për këtë situatë nga strukturat qeverisëse dhe mungesën e mobilizimit dhe organizimit ndërinstitucional për zgjidhjen e krizës.

Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj vartëse që kanë përgjegjësi në sektorin e energjisë, përkundrazi faktit se kanë bazë të mjaftueshme kushtetuese dhe ligjore për zgjidhjen e krizës, dhe përkundrazi që kanë në menaxhim të gjitha resurset teknike dhe humane për menaxhimin e krizës, deri më tani nuk ia kanë arritur ta bëjnë këtë. Ajo çka e bën situatën energjetike edhe më të rëndë në Kosovë, është hutia e kësaj qeverie e cila ende nuk ka përgjigje në pyetjet që vazhdimisht drejtohen në adresë të saj si:

- *A kemi ndonjë informacion të saktë se si dhe kur do të dalim nga kjo krizë?*

- *Cilat dhe sa do të jenë pasojat ekonomike dhe financiare të kësaj krize?*

- *Sa dhe si do ta përballojnë qytetarët këtë situatë?*

- *Si do ta kalojmë sezonin e dimrit përballë kësaj krize?*

Fatkeqësisht, Qeveria e Kosovës, në vend se të ishte e orientuar për marrjen e vendimeve dhe planifikimin e daljes nga kriza, ishte e orientuar për identifikimin dhe zbulimin e të ashtuquajturve "fajtorëve të krizës".

Një nga fajtorët e identifikuar nga qeveria për krizën ishin

konsumatorët (qytetarët), të cilët, në fakt, janë ata që po i bartin më së shumti pasojat e mungesës së energjisë dhe problemeve në jetën e përditshme që shkakton mungesa e energjisë qofshin ato sociale apo ekonomike.

Në këtë situatë nuk munguan as thirrjet e vazhdueshme të institucioneve përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës, të cilat, në mungesë të opsioneve për zgjedhjen e problemit, kërkonin nga konsumatorët kursim të energjisë, mospërdorim të energjisë për ngrohje në sezonin më të ftohtë të vitit. Në tërësi këtë stres të mungesës së energjisë, konsumatori po kërcënohet edhe me paralajmërimin e shtrenjtimit të çmimit të energjisë.

Pra qeveria aktuale, në vend se të ofrojë përgjigje në këtë pyetje, në vend se ta marrë përsipër fajin dhe t'i qaset me seriozitet zgjedhjes së problemit, po përpjet që fajin ta zhvendosë te qytetarët dhe te ish-qeveritë e kaluara.

Mirëpo nëse e analizojmë procesin e zhvillimit të kapaciteteve energjetike do të shohim që ishte pikërisht partia që ka pushtetin dhe oponentët e saj pengesa kryesore për zhvillimin e kapaciteteve energjetike të bazuara në thëngjill, qoftë përmes lobimit kundër projekteve të reja energjetike ose përmes bllokimit të vendimeve për këto projekte.

Disa nga vendimet e marra kohën e fundit nga qeveria, që ishin me mungesë transparence dhe të pamenduar mirë, ishte edhe ndarja e 20 milionë eurove për KEK-un pa asnjë bazë ligjore, para këto që duhet të kalojnë nga KEK-i te KEDS-i, ndarja e 20 milionë eurove për dividendin e KOSTT-it, mjete këto të cilat u munduan të kamuflonin tash e gjashtë muaj në retorikë populiste, si dhe mungesa e gjetjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme për mbulimin e humbjeve të energjisë në veri të vendit.

Një tjetër problem është ai që ndërlidhet me projektet e reja energjetike dhe mungesa e transparencës lidhur me procesin e vendimmarrjes nga kjo qeveri për projektin e gazit natyror të mbështetur nga ShBA-ja përmes MCC. Duke refuzuar këtë projekt pa ndonjë arsytim të mirëfilltë, kjo qeveri i ka shkakuar vendit dëme shumë të mëdha në sektorin e energjisë.

Projekti i ndërtimit të infrastrukturës së gazit, pavarësisht prej prejardhjes së tij dhe rrugëve prej nga vjen, do të duhej të ishte prioritet i vendit, jo vetëm pse Kosova ka mungesë të infrastrukturës për këtë sistem, por edhe për shkak të perspektivës së të

ardhmes dhe mundësive të shfrytëzimit të këtij gazi jo vetëm për prodhimin e energjisë elektrike, por edhe për ngrohje dhe për nevojat e amvisërisë.

Përfitimet e tjera që mund të sillte një projekt i tillë janë edhe diversifikimi i burimeve të energjisë, duke ua ofruar konsumatorëve edhe një alternativë tjetër dhe me një çmim më të arsyeshëm, duke rritur mundësinë e kursimit të energjisë elektrike dhe duke shërbyer si një alternativë mbështetëse afatgjatë përgjatë periudhës derisa të bëhen investimet e duhura në energjinë alternative dhe në procesin e tranzicionit energjetik.

Në anën tjetër, dëmet që i shkaktohen vendit për moszbatimin e këtij projekti janë të ndërlidhura me ndotjen që do të shkaktohet nga përdorimi i thëngjillit për prodhim të energjisë dhe për ngrohje, por edhe përjashtimi nga lidhja me projektet evropiane dhe globale të infrastrukturës së gazit që kanë synim të sjellin një siguri energjetike në tregun e rajonit.

Vonesa dhe paqartësia për orientimin e investimeve në sektorin e energjisë përbëjnë problem tjetër që ka prejardhjen pikërisht nga qëndrimet konfuze të Qeverisë së Kosovës. Kosova po vazhdon të vuajë nga mungesa e investimeve që do ta diversifikonin prodhimin dhe miksin energjetik, e cila do ta mundësonte ofertën e brendshme më të lirë dhe të përballueshme për qytetarët.

Vonesa në reformat për burime të ripërtërishme të energjisë dhe të investimeve strategjike përmes programeve konkrete në efikasitet të energjisë është vazhdimësi e politikave dhe vendimeve jo të qëndrueshme dhe pa vizion të kësaj qeverie.

Zbrazëtitë ligjore që ndërlidhen me miratimin e ligjeve përkatëse

sikurse është ai për burimet e ripërtërishme të energjisë dhe hapjen e tregut të ankandeve për investime në burimet e ripërtërishme nga investitorët potencialë, si dhe zbatimi i skemave të subvencionimit, vazhdojnë të jenë pengesat kryesore të këtij sektori.

Qeveria përmes Ministrisë së Ekonomisë, përmes një plani emergjent veprimi, do të mund t'u përgjigjej progresit teknologjik, teknologjive të reja të gjenerimit të energjisë, si dhe t'i fillonte bisedimet drejt ekonomisë së karbonit të ulët. Kësaj qeverie i ka munguar edhe një plan konkret që do të kishte në zhvillimin normal të sektorit energjetik duke vendosur një balancë ndërmjet mekanizmave të tregut dhe aspekteve teknike/teknologjike dhe menaxhimit të energjisë.

Mundësi reale së paku deri në vitin 2050 për Kosovën do të duhet të ishte valorizimi i burimeve të saj energjetike përmes fisnikërimit dhe gazifikimit të linjtit, si opsione për ta garantuar sigurinë e furnizimit dhe reduktimin e ndikimit negativ në mjedis.

Në kuadër të kësaj do të duhej të mbështetej KEK-u si gjeneruesi kryesor i energjisë, në reforma strukturore dhe teknologjike që do ta përfshinin uljen e emetimeve në ajër, përmirësimin e teknologjisë së prodhimit, rritjen e efikasitetit, sigurisë së furnizimit dhe hapjes së tregut.

Do të duhej të punohej më shumë edhe për ridizajnimin e tregut të energjisë elektrike, që do të kishte në fokus zhvillimin e konkurrencës së gjenerimit dhe të tregut, përfshirë edhe tregjet ndërkufitare.

Kur flasim për bashkëpunimin ndërkufitar, patjetër duhet të trajtohet me prioritet linja interkonektive 400 kV Kosovë - Shqipëri. Ndërtimi i kësaj infrastrukture energjetike do t'i bënte të dyja vendet të pasura me

burime energjetike dhe të pavarura në aspektin e prodhimit të energjisë dhe, pse jo, edhe fuqi energjetike në rajon.

Në raport me menaxhimin e situatës emergjente të krizës së energjisë, Qeveria e Kosovës do të duhej:

- Të shpallte gjendje emergjente të jashtëzakonshme - mbështetur në legjislacionin në fuqi;
- Të bëhej transparente para opinionit dhe qytetarëve për çdo transaksion qeveritar.
- Të ndërkrete urgjentisht në gjuhën dhe komunikon fyes me konsumatorët/qytetarët.
- Të dilte përtej konceptit të LV-së dhe të formonte trupa profesionale për sektorin e energjisë për rrethanat e jashtëzakonshme.
- Të hartonte urgjentisht një plan veprimi afatshkurtër njëvjeçar që të 'iërballojë' sfidat dhe pasojat e kësaj krize.

Ndërsa në raport me planifikimin afatgjatë në sektorin e energjisë disa prej hapave dhe veprimeve që qeveria duhet t'i trajtojë me prioritet janë:

- Hartimi i një strategjie afatgjatë dhe të mirëmenduar për dekarbonizimin e sistemit energjetik;
- Rritja e investimeve në efikasitetin e energjisë me qëllim të uljes së konsumit të energjisë;
- Themelimi i fondit të konsumatorëve në nevojë sipas kërkesave të Ligjit për Energjinë Elektrike;
- Fuqizimi i Fondit të Efikasitetit i cili do t'i ndihmonte qytetarët të përdornin alternativa të ngrohjes;
- Dizajnimi i pakove mbështetëse për transformimin e sistemeve të ngrohjes;
- Rritja e investimeve në burimet e ripërtërishme të energjisë;
- Hartimi i programeve të vetëdijesimit për efikasitetin e energjisë dhe mjedisin;
- Masa lehtësuese për konsumatorët.







## Politika e jashtme, joaktive

Ndërrimi i pushtetit në fillim të vitit 2021 ishte pritje me entuziazëm edhe në fushën e politikës së jashtme. Pushteti i ri kishte ngritur pritje të mëdha për fuqizimin e diplomacisë dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Por, ky vit nuk i ka sjellë Kosovës asnjë njohje dhe asnjë anëtarësim në ndonjë mekanizëm ndërkombëtar. Kjo ka bërë që njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare ta vlerësojnë me notë negative politikën e jashtme të Kosovës gjatë vitit 2021

**EPOKA ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Gjatë vitit 2011 Republika e Kosovës nuk ka pasur asnjë njohje dhe nuk është anëtarësuar në asnjë mekanizëm të rëndësishëm ndërkombëtar. Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare e kanë vlerësuar me notë negative punën e presidentes, të kryeministrit dhe të ministres së Punëve të Jashtme në arenën ndërkombëtare. “Në disa prononcime të mia gjatë këtij viti kam ngritur shqetësimet e mia se diplomacia e Kosovës

nuk po ecën me ritmin dhe drejtimin e duhur. Rrjedhimisht edhe tani në fund të këtij viti kalendarik më duhet të pohoj se politika e jashtme e shtetit të Kosovës ka çaluar shumë si në planin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, po ashtu edhe në planin e organizimit të brendshëm”, ka deklaruar profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi. Sipas tij, gjatë këtij viti Ministria e Punëve të Jashtme ka bërë ndonjë veprim të rëndësishëm. “Tani nuk dua të tingëlloj shumë mohues, por nga eksperiencia ime mund të them

se e vërteta është se nuk kemi parë ndonjë veprim të rëndësishëm në politikën e jashtme. Nuk ka njohje dhe anëtarësim të reja që do të ishin një tregues matës i cili do t'i mbështeste pohimet e presidentes dhe të ministres së Jashtme”, është shprehur ai. Kurse politologu Avdi Smajllaj ka deklaruar për gazetën se gjatë këtij viti politika e jashtme ka reflektuar në masë të madhe karakteret e bartësve kryesorë të institucioneve të kësaj fushe. “Ashtu sikurse ndryshimi i pushtetit që u prit me entuziazëm nga një masë e gjerë qytetare, edhe për Ministrinë e Punëve të Jashtme kishte pritje të mëdha. Por, ajo që faktikisht rezultoi nga qeveria e pushtetit i ri, në përgjithësi u reflektua edhe në politikën e jashtme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme si bartëse kryesore, por jo e vetme, e politikës së jashtme. Në periudhën gati njëvjeçare të qeverisjes nga kjo qeveri, politika e jashtme ka reflektuar në masë të madhe personalitetet (karakteret) e bartësve kryesorë

të politikës së jashtme, si të ministres, presidentes dhe të kryeministrit”, ka thënë Smajllaj. Ai ka bërë me dije se politika e brendshme ka reflektuar në politikën e jashtme. “Diskursi i brendshëm grindavec i retorikës dhe përplasjes me opozitën dhe të kaluarën përbën pjesën më të madhe të aktiviteteve të bartësve të politikës së jashtme, gjë që ka dëmton rëndë politikën e jashtme të Kosovës, duke mos e trajtuar mbrojtjen interesit të Kosovës jashtë saj, që do të duhej të ishte fokusi kryesor i politikës së jashtme”, ka deklaruar ai. Edhe njohësi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Valon Murtezaj, ka vlerësuar se Kosova nuk është sjell në mënyrën e duhur në arenën ndërkombëtare. “Politikat qeverisëse të punëve të jashtme zakonisht duhet të përfshijnë spektër të gjerë të formave dhe mënyrave të të bërit diplomaci. Të kuptuarit e saktë të nevojave dhe vlerësimi i kapaciteteve, ndihmojnë funksionim më të mirë të politikës së jashtme. Kjo pastaj do të mundësonte një sjellje diplomatike adekuate që

do të kishte për efekt rezultate të prekshme në shumë fusha të punëve të jashtme. Kosova ka nevojë të bëjë diplomaci unike, sepse nevojat e saj janë unike. Kjo nënkupton që prioritetet të përcaktohen qartë dhe pastaj të mobilizohen të gjitha resurset e mundshme brenda dhe jashtë Kosovës për t'u vënë në shërbim të synimeve të politikës së jashtme. Në vitin 2021 aktivitetet në politikën e jashtme të Kosovës kanë qenë të kufizuara”, ka thënë për gazetën Murtezaj. Sipas Murtezajt, Qeveria e Kosovës duhet ta bëjë prioritet politikën e jashtme. “Politika e jashtme është një fushë e gjerë e veprimtarive politike, strategjike dhe sjelljes diplomatike të një vendi në kuadër të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kur kemi parasysh që shteti i Kosovës është shtet i ri, atëherë kjo nënkupton që politika e jashtme do të duhej të ishte ndër prioritetet e qeverisë. Nëse bëjmë një vështrim real, këtë nuk kemi mundur ta vërejmë gjatë vitit që po lëmë pas. Përveç disa aktiviteteve me artisten tonë të





famshme Dua Lipa, që mund të theksohen si të efektshme për promovimin e Kosovës dhe si formë e diplomacisë publike, aktivitetet e tjera që kemi parë mund të cilësohen rutinore dhe tradicionale, por jo angazhime dinamike dhe intensive, që do t'i adresonin nevojat e mëdha që ka Kosova në këtë periudhë të konsolidimit në arenën ndërkombëtare”, ka thënë Murtezaj.

### Gafat e ministres Gërvalla

Ato që kanë rënë në sy gjatë këtij viti kanë qenë gafat e ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. Në llogarinë e saj në “Twitter”, kryediplomatja ka gabuar pothuajse në secilin publikim. Vazhdimisht ajo ka ngatërruar flamujt e vendeve që e kanë njohur Kosovën dhe, ndër të tjera, edhe flamurin e NATO-s me atë të OKB-së. Sipas njohësve të kësaj fushe, këto veprime të saj prekin dinjitetin e vendeve që ua ngatërron flamujt. “Është e vërtetë se kemi parë disa vizita të ministres, por kemi parë edhe disa gafa të saj dhe disa deklarata mjaft kundërtshënese dhe me shkarje faktografike, me të cilat, mbase pa dashje, i është bërë shërbim diplomacisë serbe. Unë nuk e di sa ministria e ka të konsoliduar

stafin këshillëdhënës dhe sa e konsulton atë. Sa di unë, MPJ-ja ka diplomatë të karrierës, por edhe jashtë MPJ-së ka ekspertë të mirë, të gatshëm ta ndihmojnë diplomacinë, respektivisht afirmimin e shtetit të tyre në planin e jashtëm. Si përfundim mua nuk më rezulton ndonjë parametër afirmativ që do të mund ta vlerësonte me notë pozitive punën e MPJ-së gjatë këtij viti që po e lejmë pas”, ka thënë profesori Gashi. Edhe politologu Smajllaj gafat e ministres Gërvalla i ka cilësuar skandale. Ai ka thënë për “Epokën e re” se politika e jashtme e Kosovës është pa strategji dhe objektiva. “Bartësit e politikës së jashtme gjatë kësaj periudhe ende nuk kanë krijuar strategji të Kosovës në politikën e jashtme, që do të thotë ende nuk kanë objektiva të qarta në politikën e jashtme. Ende institucionet tona nuk kanë arritur të definojnë se çka duam të arrijmë në politikën e jashtme dhe si mund të arrihet kjo në politikën e jashtme. Në nivelin bilateral, Kosova ka ngecur në thellimin e marrëdhënieve diplomatike, përjashtuar disa marrëveshje me Shqipërinë (që do të duhej konsideruar të pakta e të vonshme nëse marrim për bazë relacionet e veçanta që do të duhej t'i kishim), gjë që dëshkohet me numrin e

marrëveshjeve bilaterale gjatë kësaj periudhe”, ka thënë ai, duke shtuar se Kosova është treguar pasive në politikën e jashtme. “Kosova ka treguar një qasje pasive, duke mos pasur asnjë iniciativë rajonale, si dhe duke i personalizuar e përdorur për retorikë elektorale zhvillimet e ndryshme rajonale në të cilat Kosova do të duhej ta impononte vetveten përmes një qasje proaktive dhe të qartë, gjë që ka munguar gjatë kësaj periudhe. Sa i përket dialogut, është dëshmuar një konfuzion e mungesë e vizionit, vazhdimisht duke iu ndërruar vendet në listën e prioritetëve, herë duke e kushtëzuar dialogun me përgjegjësi për gjenocidet e Serbisë në Kosovë, duke filluar nga viti 1878 e deri më sot, herë duke e injoruar edhe çështjen e të pagjeturve në procesin e dialogut”, është shprehur Smajllaj.

### Shkarkimi i ambasadorëve, i paprecedent

Veprimi që ka bërë bujë më së shumti në fushën e politikës së jashtme ka qenë shkarkimi i 12 ambasadorëve në muajin maj. Për më shumë se pesë muaj, 21 ambasada mbetën pa përfaqësim të rangut të ambasadorëve. Kësisoj, Kosova e

uli nivelin e përfaqësimit me të ngarkuar me punë në të gjitha këto misione.

Tërheqja e ambasadorëve pa një plan për zëvendësimin e tyre dhe pa vlerësim të punës së tyre është konsideruar veprim jo i mençur nga njohësit e fushës së politikës së jashtme. “MPJ-ja këtë vit e karakterizoi mungesa e profesionalizmit dhe veprimet e ngutshme, si ai për tërheqjen e ambasadorëve politikë në mes të mandatit të tyre, pa kryer paraprakisht zëvendësimet e tyre, duke lënë shumë shtete të rëndësishme pothuajse gjatë tërë vitit në nivelin e përfaqësimit më të ngarkuar me punë”, ka thënë profesori Ibrahim Gashi. Sipas tij, asnjë vend nuk ka bërë shkarkimin e ambasadorëve pa vlerësim paraprak. “Nuk ka ndonjë vend në botë që pa bërë një vlerësim paraprak të performancës dhe pa iu tërhequr vërejtjen për performancë të dobët të shkarkojë mbi dhjetë ambasadorë me një vendim njëkohësisht. Ky veprim, përpos që le vend për të dyshuar, se nuk është në përputhje me Ligjin për Shërbimin Diplomatik, lë shije të keqe te shtetet pritëse. Për më shumë, kjo është mungesë e skajshme e profesionalizmit dhe politizim i diplomacisë në emër të depolitizimit”, ka thënë ai. Sipas politologut Avdi Smajllaj,

shkarkimi i ambasadorëve nuk është bërë në mënyrë institucionale. “I vetmi aktivitet i Ministrisë së Punëve të Jashtme në politikën e jashtme, gjatë kësaj periudhe, ishte shkarkimi dhe emërimi i disa ambasadorëve, që është më shumë çështje administrative, procedurale, e protokollare sesa politike në kuptimin e politikës së jashtme - avancim i interesit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Madje edhe këto shkarkime nuk janë bërë në frymën institucionale duke bërë një vlerësim paraprak të punës së secilit, gjë që do të krijonte praktikë institucionale në këtë proces, i cili vazhdimisht, edhe në qeveritë e kaluara, është lënduar rëndë me nepotizëm, favoritizëm e klientelizëm”, ka deklaruar ai.

Vetëm në muajin tetor është bërë emërimi i ambasadorëve të rinj. Që nga shpallja e pavarësisë më 2008 Kosova ka hapur 32 misione diplomatike në vende të ndryshme të botës. Pavarësisht prej kritikave të shumta, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe kryediplomatja Donika Gërvalla pretendojnë se kanë ndryshuar për të mirë politikën e jashtme të Kosovës. Sipas tyre, me vizitat e pakta që kanë pasur jashtë vendit kanë ndikuar në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.





# SADO E ERRËT TË DUKET E TASHMJA, SHPRESAT PËR TË ARDHMEN NUK SHUHEN KURRË



**Dr. Edita TAHIRI**

*Ish-zëvendëskryeministre dhe ministre e Punëve të Jashtme Prishtinë, 29 dhjetor 2021*

Dy vjet nga pandemia na bënë të kuptojmë se nuk e ka ndër mend të shkojë aq shpejt. Varianti Omicron i këtij virusi po përhapet gjithandej, ndërsa kombet e varfra mbeten më pak të vaksinuarat. Ekspertët thonë se gjendja e sotme shëndetësore në botë nuk ka qenë asnjëherë më e rënda gjatë njëqind vjetëve të fundit. Por, pandemia globale nuk është e vetmja krizë me të cilën po përballet bota. Shumë kriza të tjera kanë kapluar botën, si vendet e zhvilluara ashtu edhe ato të pazhvilluara, pa dallim. Është një kohë përplot kontraste e absurditete, megjithatë duhet ta gjejmë sërish shpresën.

Filozofi francez i absurdeve dhe shpresës, Albert Camus, në përfundim të esesë së tij "Miti i Sizifit", thotë se ndërsa shpresa është një dikotomi e rreme përballë absurdit, e krijuar për t'i ndihmuar njerëzit të përballen me absurditetin e ekzistencës, ne duhet të përpiqemi ta gjejmë shpresën për t'i dhënë kuptim jetës.

Jam e bindur se Albert Camus në kohën kur ka trajtuar krizat e asaj kohe, nuk e ka menduar se një botë shumë më e zhvilluar se ajo mund të përballet me kriza të tilla që seriozisht kërcënojnë shpresën për të ardhmen.

Kontrastet apo absurdet e botës së sotme, duke përfshirë rëniet ekonomike, pandeminë Covid-19, rritjen e mosbesimit global, konfliktet e reja dhe të vjetra, problemet klimatike, varfërinë në rritje, përshkallëzimin e luftërave gjeopolitike që janë rikthyer si një "luftë mes përbindëshash të

kohës moderne", e shumë absurde të tjera, nuk kanë lënë të qetë asnjë pjesë të botës.

Është kjo kohë kur horizonti është mbuluar nga frika, tragjedia dhe pesimizmi. Kohë e ndarjeve në vend të bashkimeve. Kohë kur po bëhet një ndarje shumë e qartë dhe më tragjike mes Perëndimit dhe Lindjes, mes liberalizmit dhe joliberalizmit, mes demokracisë dhe autokracisë, mes të pasurve dhe të varfërve, mes të korruptuarve dhe të ndershmeve, ndërkohë që kategoritë që po pësojnë më së shumti janë të marginalizuarit.

Prandaj, ringjallja e shpresës është e domosdoshme. Kjo kohë kërkon ringjalljen e "Aleancës për të mirën" përballë "Boshtit të djallit" që tashmë po sulmon nga çdo platformë, qoftë ajo e marrëdhënieve ndërkombëtare deri te marrëdhëniet ekonomike e digjitale.

Kontradiktat në marrëdhëniet Perëndim-Lindje, ShBA-Rusi dhe ShBA-Kinë janë prova që do ta përcaktojnë paradigmen e marrëdhënieve të reja në botë, më saktësisht ndërmjet botës perëndimore dhe lindore. Prandaj, kërkohet një rikthim i fuqishëm i ShBA-së, si një superfuqi që mbajti dhe garantoi paqen dhe demokracinë globale, ndonëse kjo ishte punë e OKB-së e cila doli e munguar në krizat e kohës duke përfshirë këtu krizat në Ballkan në tridhjetëvjeçarin e fundit, e mos të përmendim se në Siri, Afganistan, Jemen e konflikte të tjera gati se nuk u duk fare. Ndërkohë, Bashkimi Evropian, ndërsa po orvatet ta rrisë ndikimin e saj në Afrikë dhe Azinë e largët, ka lënë Ballkanin e oborrit të vet në një zjarr që Serbo-Rusia e ka krijuar për ta rikthyer influencën e humbur në rajon, përmes armatosjes së Serbisë dhe projektit hegjemonist për "Serbinë e Madhe". NATO-ja, nga ana e saj, u mjaftua me reagime me fjalë, teksa hartoi strategjinë për t'u mbrojtur nga Rusia, që shpresojmë ta jetësojë.

Por le të kalojmë në absurdet

e Ballkanit për të parë se si dinamikat e brendshme dhe të jashtme kanë shmangur Ballkanin nga shpresa. I nisur drejt demokracisë dhe perëndimit për t'u bërë pjesë e BE-së dhe NATO-s, pas zhbërjes së ish-Jugosllavisë dhe lindjes së shtatë shteteve të reja, me Kosovën si shtetin më të ri, tashmë Ballkani ka arritur në udhëkryq. Ballkani po dridhet nga jostabiliteti, dhe jostabilizuesi është i njohur - është Serbia e Vuçiqit e mbështetur nga Rusia. "Putin po luan me zjarrin në Ballkan" thotë revista prestigjioze amerikane "Foreign Affairs", ndërsa fton që Kosova dhe Bosnja e Hercegovina të pranohen në NATO sa më shpejt. Kjo revistë e njohur për

politikë të jashtme, gjeopolitikë dhe çështjet globale ka ngritur alarmin në maksimum, duke theksuar se "neglizhenca e vazhdueshme nga ana e Perëndimit ka kontribuar në një kthim dramatik prapa në vitet e fundit, të cilën Putini po e shfrytëzon si fushëbetejë e radhës për ta dobësuar NATO-n dhe Bashkimin Evropian." Absurdi tjetër është se midis Ballkanit po krijohet dualizmi i dy sistemeve të sigurisë globale - me njërin anë NATO-ja, në anën tjetër Rusia, si një rishfaqje e një "mini-Pakti të Washavës". Këtij dualizmi të rrezikshëm të sigurisë po i kontribuon edhe një "bosht pro-rus i disa vendeve brenda BE-së" ndaj të cilëve BE-ja nuk po ndërmer kurrfarë masash ndaluese. Dhe krejt në krye, si një dinamikë e brendshme qëndron "Ballkani i hapur" që bart më vete rrezikun e rikthimit të hegjemonisë serbo-ruse në Ballkan përmes synimeve për krijimin e "Serbisë së Madhe." Ky projekt i nisur me gjoja premisa ekonomiko-tregtare është mbulesa për zjarrin që po i vihet Ballkanit, para syve tanë dhe partnerëve perëndimorë. Tashmë ekzistenca e Bosnjës është në pikëpyetje serioze nga tendenca të fuqishme separatiste të "Republika Serbska-s" së Dodikut. Duke qenë se Serbo-Rusia dështoi ta ndajë Kosovën pak vite më parë, përmes lojës së "shkëmbimit të territoreve", tani loja gjeopolitike për krijimin e "Serbisë së Madhe" ka nisur nga Bosnja.

Edhe më keq që kumbarë të kësaj pune janë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Maqedonisë Veriore, Zaev.

Prandaj, një ringjallje e aleancës perëndimore është ringjallje për të mirën, është ringjallje e shpresës për gjithë vendet që kanë ideale të vlerave perëndimore.

Nuk po e mbyll këtë shkrim pa përmendur disa prej absurdeve të Kosovës. Derisa po e shkruaj këtë artikull, herë nuk ka rrymë e herë ujë, pra jemi kthyer në gjendjen e menjëherë pas luftës. Çmimet janë rritur, pagat jo. Punësimet familjare dhe bordet e reja politike nuk i kanë shpëtuar as kësaj qeverie. Por absurdi më i madh është se derisa ne diplomacia e viteve të okupimit sollëm aleancën me Amerikën dhe ShBA-në e quajmë "shpëtimtare", kjo qeveri jo vetëm që nuk denjon ta quajë me emrin që e meriton, por përkundrazi ka cenuar marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Ikja e rinisë nga mosshpresa ka vazhduar nga Kosova, Shqipëria dhe gjithë rajoni, për ta gjetur shpresën gjëkund nëpër botë. Në Shqipërinë mëmë disa shkëndija të shpresës janë ndezur, një revolucion paqësor demokratik ka nisur, për ta kthyer dëshpërimin në shpresë.

Dhe në vend të urimit për vitin e ri, dua ta citoj presidentin amerikan Franklin Delano Roosevelt, i cili thotë: "Sado e errët të duket e tashmja, shpresat për të ardhmen nuk mund të shuhen kurrë".







# Dialog pa rezultat

Procesi i dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk ka sjellë ndonjë rezultat gjatë vitit 2021. Në takimet e nivelit politik dhe teknik në Bruksel, të dyja vendet kanë shprehur vullnet për ta vazhduar këtë proces, por jo për t'u pajtuar për ndonjë çështje konkrete. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë shtuar presionin ndaj palëve duke u bërë thirrje për sjellje konstruktive. Sipas tyre, ka ardhur koha që dialogu i Brukselit të sjellë rezultate konkrete drejt marrëveshjes përfundimtare



© Bahri Cani/DW

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 DHJETOR - Me konstituimin e institucioneve të reja rifilloi edhe procesi i dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Qeveria e drejtuar nga kryeministri Albin Kurti, ndonëse nuk dëshironte ta trajtonte këtë çështje si primare të qeverisjes, ajo u bë prioritet. Sikurse qeveritë e mëparshme, edhe qeveria Kurti emëroi zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi, kryenegociator në dialogun me Serbinë, i cili ka zhvilluar disa takime të nivelit teknik me palën serbe në Bruksel.

Nën ndërmjetësimin e përfaqësuesit të lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Joseph Borrell, dhe emisarin special Miroslav Lajçak, Kosova dhe Serbia kanë zhvilluar edhe dy takime të nivelit të lartë politik.

As në nivelin teknik dhe as në atë politik nuk është arritur ndonjë rezultat.

Në këto takime palët pothuajse nuk janë pajtuar për asgjë.

Më 15 qershor është mbajtur

takimi i parë në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ashtu siç pritej, takimi nuk prodhoi asnjë rezultat. Kryeministri Albin Kurti në takim kishte bërë disa propozime të cilat ishin refuzuar nga ndërmjetësuesi dhe presidenti serb.

Takimi i dytë është mbajtur në mes të korrikut. Ky takim kishte sjell vetëm ofendime dhe tensione në mes të palëve. E kaluara ishte ajo që sërish kishte përplasur kryeministrin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Takimi ishte shumë më i shkurtër sesa që ishte planifikuar, sepse palët nuk ishin dakord pothuajse për asgjë. Pas bisedimeve u dëgjuan madje edhe fjalë të rënda në adresë të njëri-tjetrit. "Ne kemi prezantuar në takim një marrëveshje të balancuar prej gjashtë nenesh, për paqe në mes të Serbisë dhe Kosovës, e cila u refuzua pa u lexuar fare. Zëvendëskryeministri (Besnik) Bislimi i ka lexuar 11 pikat që paraqesin pengesa në raportet tregtare të Kosovës me vendet e tjera, që ne kerkuam të hiqen, por as kjo nuk u pranua", kishte deklaruar Kurti pas takimit.

Ndërsa presidenti serb e kishte akuzuar palën e Kosovës se dëshiron të flasë vetëm për të kaluarën.

## Zbatohet reciprociteti në targa

Më 20 shtator Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që automjetet nga Serbia, sapo të hyjnë në Kosovë, duhet t'i ndërrojnë ose mbulojnë targat e tyre dhe të marrin regjistrim të përkohshëm të Kosovës. Në këtë mënyrë është vendosur masa e reciprocitetit për targat e Serbisë, pasi një gjë të ngjashme Serbia e ka aplikuar për automjetet nga Kosova për më shumë se dhjetë vjet. Ndaj këtij vendimi kanë reaguar serbët lokalë duke bllokuar rrugët që të dërgojnë në dy vendkalimet kufitare në veri të Kosovës, Jarinjë dhe Bërnjak. Për ta zgjidhur këtë çështje palët shkuan në Bruksel.

Pas dy ditësh negociata, Kosova dhe Serbia arritën një

marrëveshje për shtensionimin e situatës në veri. Marrëveshja parashihte reciprocitet në targa në mes të dy shteteve, duke ua mbuluar simbolet shtetërore. Sipas dokumentit trepikësh, njësitet speciale policore që ishin të vendosura në pikëkalimet kufitare duhet të largohen bashkë me barrikatad, ndërsa për dy javë aty kanë qëndruar trupat e KFOR-it.

Pika e tretë e saj parashihte që në fund të tetorit të nisë punën një ekip i përbërë nga zyrtarë të Bashkimit Evropian, Prishtinës dhe Beogradit, për të gjetur një zgjidhje të përhershme. Brenda gjashtë muajve, prej nisjes së takimit të parë, i ashtuquajtur grup punues do t'i paraqesë gjetjet për një zgjidhje të përhershme në formatin e dialogut të nivelit të lartë.

Qeveria e kishte cilësuar këtë marrëveshje si fitore, ndërsa opozita e ka kritikuar, duke thënë se vetëm ka zbatuar një marrëveshje që është arritur para disa vjetëve.

treatat e tyre s'janë implementuar nga Serbia, por gjithmonë Beogradi zyrtar dëshiron ta përmendë një marrëveshje që më duhet ta them s'e ka kaluar testin e Gjykatës sonë Kushtetuese. Më kujtohet, më 2015, kur në vendimin e saj asnjë serb i Kosovës nuk protestoi, por vetëm Beogradi. Besoj se është koha që të ketë dialog, ku populli, qytetarët, janë përfituesit e jo politikanët. Prandaj na duhet karakter demokratik i dialogut që njerëzit të fitojnë. E rithekoj se në fund të dhjetorit të 2015 serbët nuk u bregosën fort për vendimin e Kushtetueses, por ishte Beogradi që po vajtonte për atë që ka ndodhur", ka thënë kryeministri Kurti në konferencën e përbashkët me përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell.

Ky i fundit ka kërkuar zbatimin e kësaj marrëveshje, pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. "Pajtohemi që Gjykata Kushtetuese (e Kosovës) vendosi pengesa për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Por, kjo (marrëveshje) u arrit ndërmjet përfaqësuesve të dy qeverive dhe në kuadër të dialogut. Kështu që, më vjen keq, por na duhet ta kërkojmë zbatimin e kësaj marrëveshjeje", ka thënë Borrell.

Në të gjitha takimet e nivelit politik dhe teknik palët janë shprehur për vazhdimin e bisedimeve për një marrëveshje përfundimtare në mes të dy vendeve, por nuk kanë treguar vullnet për të ecur drejt këtij qëllimi.



## Presioni për formimin e asociacionit

BE-ja dhe ShBA-ja vazhdimisht gjatë vitit 2021 kanë kërkuar nga Kosova zbatimin e marrëveshjes për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, kurse kryeministri Albin Kurti ka refuzuar një gjë të tillë, duke thënë se formimi i asociacionit njëetnik është kundër Kushtetutës së Kosovës.

Në takimin e katërt të Këshillit të Stabilizimit dhe Asocimit (MSA), qëndrimet e kundërta për këtë çështje janë bërë edhe publike. "Janë 33 marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe dy të



# Qeveria, idetë korruptive dhe PDK-ja opozitare



**Shkruan: Faton ABDULLAHU**

## Qeveria

Sa më të errët e paraqet qeveria aktuale të kaluarën e dy dekadave të fundit në Kosovë aq më të përshtatshme i krijon rrethanat në të cilat një sukses i saj sado i vogël sot do të perceptohet si fitore e madhe. Ose ndryshe, sa më zi thuhet e flitet për qeveritë e kaluara aq më shumë amortizohet e minimizohet çdo dështim i tashëm i qeverisë. Kriza energjetike këto ditë e ilustron këtë më së miri. Me fjalët që ta çojnë tugin të kryeministrit Kurti 'Kosovën e kemi gjetur të gjakosur dhe përtokë në të gjithë anët', ky populizëm, dikur opozitar, tash qeverisë,

kuptohet drejt e mirë sa i shtrembët e i padrejtë është. Thënë përmbledhtazi, qëllimi i këtij koncepti të ri, por regresiv qeverisë, është për të arritur te përfundimi në të parë i logjikshëm, por në realitet i dekadent - nuk mundemi ne për disa muaj t'i riparojmë dështimet e juaja për dy dekada. Duhet shumë vite për t'i filluar ndryshimet pozitive. Për rrjedhojë, sipas kësaj logjike, e keqja është se ndërkohë qytetari duhet të presë e të durojë për ditë më të mira dhe të mos ankohet e kundërshtojë në këto ditë të këqija.

Ky koncept politik dhe tashmë qeverisë nuk është i mundshëm të ndërtohet as të mirëmbahet me fakte, sepse është rrenë. Kjo është ndërtaur dhe mbahet gjallë me bindje ideologjike. Në rastin e Kosovës kjo ideologji është majtiste populiste e cila vdes për ta filluar një etapë të re duke e rishkruar një epokë të kaluar ku Kosova u çlirua, u bë shtet dhe është vendi më demokratik në Ballkanin e mbetur jashtë BE-së. Kërkohebt bindje populiste për ta kuptuar partiakisht konceptin torollak

'qe 20 vjet është shkatërruar ky vend' për t'u kthyer pastaj në besim të verbër politik. Kështu e kaluara po bëhet më rëndësishme se e ardhmja, sepse duhet të mbrohet e tashmja nga sukseset e kaluara dhe nga dështimet dhe mungesa e vizionit për të ardhmen.

## PDK-ja

Krejt kjo që thashë më sipër nuk është krejt dhe nëse shihet ndaras nga kjo që do të them më poshtë mund të konsiderohet me të drejtë e mangët dhe jo fer. Të kuptohemi, kur ne si opozitë, pra si PDK, konstatojmë se qasja regresive 'qe 20 vjet e keni shkatërruar këtë vend' është gënjeshtëre dhe e pamoralshme, ne nuk po e ndërtojmë mbi këtë qasje kauzën dhe alternativën tonë politike. Jo, në asnjë mënyrë. Kjo do të ishte krejt e pamjaftueshme për PDK-në. Ne nuk po themi se si PDK ne humbëm në zgjedhjet e fundit nacionale, aq sa humbëm, sepse qytetarët u gënjen plotësisht nga partia fituese dhe ne nuk jemi fajtorë për asnjë dështim dhe për asnjë ngecje në dy

dekadat e fundit. E vërteta nuk është kështu bardh e zi. Po të mendonim kështu i bie që ne si PDK sot nuk kemi pse të reformohemi, s'kemi pse të sjellim kuadro të reja në parti, aq më pak na duhen idetë e reja dhe progresive. Për më shumë kjo i bie që ne duhet të kthehemi krejt me të vjetrën, ashtu sikundër kemi qenë që të fitojmë ashtu sikundër kemi fituar në të kaluarën. Po e përsëris e vërteta nuk është kështu bardh e zi. Është më e ndërlikuar. Për më keq, në këtë rast kjo do t'i binte që qytetarët kanë gabuar në çdo aspekt në zgjedhjet e fundit nacionale. Jo, kjo nuk qëndron. PDK e ka marrë mësimin nga dështimi në zgjedhjet e fundit parlamentare, e ka lexuar humbjen drejt dhe tash sa kohë është duke vepruar në koordinim me këtë realitet të ri. Kjo është e vërtetë, po aq sa është e vërtetë që ky qytetar dhe jo vetëm ky, por edhe OJQ-të, mediet dhe analistët dhe i gjithë spektri jashtë opozitës partiake, e cila ishte shumë dhe pa rezerva me LV-në para zgjedhjeve, po shpreh zhgënjim të madh për qeverisjen aktuale e për

përkrahjen që ia ka dhënë partisë fituese, gjë që këtë po e shpreh me doza të mëdha pendimi dhe me kritika të ashpra për dështimet e qeverisë aktuale.

Jam i bindur se një parti politike e ka më të lehtë t'i largojë nga radhët e veta njerëzit e korruptuar sesa idetë korruptive. E para nuk është e lehtë përkundrazi, por e dyta është pothuajse e pamundur. Idetë korruptive determinojnë ideologjinë populiste e, për rrjedhojë, qeverisjen me ideologji korruptive. Kjo në gjenezë nënkupton të thuash dhe të bësh diçka tjetër në opozitë dhe të thuash e bësh diçka tjetër në pushtet. Korrupsioni këtu nënkupton të marrësh shumë vota me shumë mashtrime. Sot, demaskimi me arkiva, duke nxjerr video se çka është thënë dje e çfarë po thuhet e bëhet sot, është mjeti më efikas, demaskuesi më demokratik i realitetit korruptiv qeverisë. Natyrisht ky është vetëm fillimi. Në vitin e ri që po hyjmë do të ketë ide të reja opozitare, kuadro të reja dhe alternativë të re politike. Me këtë dëshirë, gëzuar 2022!

# Jeffrey Hovenier betohet ambasador i ShBA-së në Kosovë

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Ambasada Amerikane në Prishtinë ka njoftuar se më 28 dhjetor Jeffrey Hovenier është betuar ambasador i ri i Shteteve të Bashkuara në Kosovë. Ai e ka kryer betimin para nënsekretares amerikane të Shtetit për Çështje Politike, Victoria Nuland. Hovenier është diplomat karriere i shërbimit të jashtëm amerikan, i cili ka qenë pjesë e stafit të të dërguarit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës. Në muajin tetor, në një seancë dëgjimore para Komitetit të Senatit për Marrëdhënie me Jashtë, Hovenier ka thënë se, nëse konfirmohet në postin e ambasadorit, ai do ta ketë prioritet vazhdimin e mbështetjes amerikane për një Kosovë sovranë e demokratike. Ai, po ashtu, ka thënë se do ta inkurajojë Kosovën për konstruktivitet dhe fleksibilitet në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Hovenier është nominuar për ambasador në Kosovë në muajin korrik nga presidenti amerikan



Joe Biden. Për ta marrë detyrën ka qenë i nevojshëm konfirmimi i Senatit.

Hovenier do ta zëvendësojë në këtë pozitë ambasadorin e deritanishëm amerikan Philip

Kosnett, mandati i të cilit përfundon në fund të vitit. Kosnett është larguar nga Kosova

pak muaj më parë, ndërsa në detyrë ka mbetur zëvendësi i tij Nick Giacobbe.





**Shkruan: Adri NURELLARI**

## Viti i shkëlqimit dhe rënies së shokut Kurti

Viti që po lëmë pas përbën “shkëlqimin dhe rënien” shembullore të shokut Kurti dhe lëvizjes populiste Vetëvendosjes që ai ndërtoi. Mes shumë rrëmujave e zhvillimeve politike të vitit që kaloi, padyshim më i rëndësishmi ishte humbja e 63 për qind të votave nga Vetëvendosja brenda vetëm tetë muajsh. Një shfryrje kaq e shpejtë e masive e tullumbaces elektorale të 14 shkurtit, është një rast i rrallë, për mos të thënë i pashembullt, mes vendeve të tranzicionit.

Në njëfarë mënyre kjo parti politike u bë viktimë e suksesit të saj, një pre e monstrumit që ajo vetë ndërtoi. Ia ka dalë me sukses që për ta siguruar pushtetin t’i damkosë e t’i njollosë kundërshtarët duke ndërtuar pritshmëri të ekzagjeruara, aspirata të tepruara, duke toksikuar qytetarin e Kosovës me një frustrim e maraz të papërmbytshëm për arritjet dhe aktorët e mëparshëm të Kosovës, që u fermentua masivisht dhe materializua në një tërmet elektorale më 14 shkurt.

Veprimtaria e kësaj organizate politike është lehtësisht e shpjegueshme edhe me literaturën tashmë të pasur që ekziston për partitë politike populiste. Shumica e elementeve që kanë përcaktuar studuesit e fushës, identifikohen lehtësisht tek Vetëvendosja. Propaganda anti-establishment, për një shoqëri të ndarë në dy kampe antagonistë ku flitet për “një popull të kulluar”, “për masat e nëpërkëmbura” kundrejt “elitës së kalbur” apo “kastës qeverisëse” të shantazhuar. Pretendimi i përfaqësimit autentik të drejtpërdrejt të zërit të popullit gjatë veprimtarisë politike. Përdorimi i demagogjisë

në formën e akuzave të rënda e thirrje për dënime duke mobilizuar pakënaqësi e manipuluar masat. Në rastin e LVV-së akuzat për tradhti ndaj atyre qeveritarëve të shantazhueshëm për shkak të korrupsionit të tyre. Kanë një dekadë e gjysmë që Kurti dhe shokët e tij pretendojnë të jenë zërat autentikë dhe përfaqësuesit e vetëm të “popullit të thjeshtë”, “patriotëve të zakonshëm” dhe “qytetarëve të ndershmë” të injoruar nga “elitave sunduese” pro-globaliste dhe “establishmentet e korruptuara”. Këtu recetës populiste të LV-së i shtohen edhe “thirrjet linçuese për ndëshkim” apo “hajnat në burg”.

Një tjetër indikator populist është prania e një lideri karizmatik energjik me aftësi të mira komunikuese. Garimi me një ideologji të cekët e të thjeshtë dikotomike, “ne-popull”, ata “pushtetarët. Ndërtimi i një grupimi laraman me njerëz të përkatësive e shtresave nga më të ndryshme të cilët i bashkon vetëm frustrimi dhe iluzioni e një përmbysje “tabula rasa”, mund të sjellë begatinë e menjëhershme e të shumë-kërkuar. Mirëpo elementi më karakteristik i Vetëvendosjes por edhe lëvizjeve të tjera politike populiste evropiane është padyshim fajësia e “elitave sunduese” për të gjitha dështimet reale dhe të imagjinuara të shoqërisë. Pra iu thuhej qytetarëve që ata ishin shenjtore, nuk kanë asnjë përgjegjësi individuale sepse edhe për problemet personale përgjegjësia kryesore ishte e qeverisë.

Rasti më eksplicit dhe i hidhur i kësaj qasje është mohimi apo anatemi i gjithçkaje të bërë në Kosovë prej çlirimit vetëm për të fajësuar rivalët politik dhe për të

kultivuar një pakënaqësi shpërthyes. Tashmë është e qartë se gjatë kësaj deкаде të përfshirjes në politikë elektorale të Vetëvendosjes, kjo organizatë ka pasur një sukses të jashtëzakonshëm në denigrimin dhe nxirjen e realitetit të Kosovës. Në qendër të kësaj fushate nihiliste të sterosjes së realitetit kosovar, ka qëndruar parulla, “këta e kanë shkatërruar Kosovën këto 20 vjet”, që ka ngjitur tek shumë qytetarë. Madje ky tregim politik arrin kulmin e vetë ku komunat e fituara të Vetëvendosjes paraqiten si “të çliruar”, kinse 12 qershor i vitit 1999 nuk është asgjë përpara çlirimtarëve të Kurtit. Aq shumë është përmendur kjo shprehje e “shkatërrimit të Kosovës në këto 20 vjet”, në mënyrë konsistente e këmbëngulëse sa përnjëmend ka ngjitur tek opinioni i qytetarëve dhe është kapërdirë pa u përlytur si një e vërtetë. Mirëpo një reflektim i thjeshtë gjakftohtë, një këndvështrim në retrospektivë i historisë së Kosovës, nxjerr në pah sa gjenjeshër e shëmtuar ka qenë kjo ku është bazuar.

Së pari njëherë lufta e Kosovës është një ndër ngjarjet historike që ka marrë më së shumti vëmendje ndërkombëtare, për shkak edhe të përfshirjes së ShBA-ve dhe ndërhyrjes së NATO-s. Nuk e vë kush në dyshim që regjimi i Millosheviqit e ka lënë Kosovën të masakruar, shkatërruar, djegur, zbratur e përdhunuar pas luftës. Janë fakte tashmë botërisht të pranuar shifrat e rënda të spastrimit etnik dhe krimeve të luftës të shkaktuara prej shtetit serb në Kosovë. Mirëpo kjo e vërtetë e pakundërshtueshme historike, nuk e ka penguar Vetëvendosjen që të trillonte, e ndërtonte një perceptim të rremë, kinse

“Kosova ka qenë mirë para 20 vjetësh, por erdhën këta çlirimtarët dhe e shkatërruan”. Me pak fjalë të thuash që “këto 20 vjet këta e kanë shkatërruar Kosovën”, në mënyrë të tërthortë deklarohet se Kosova ka qenë në gjendje të mirë pas luftës, por këta që erdhën pas luftës e shkatërruan atë që na kishte lënë trashëgim Millosheviqi. Thënë ndryshe propaganda e suksesshme e Vetëvendosjes ka përbërë formën më efektive të relativizimit dhe apologjetizmit të krimeve serbe në Kosovë, për qëllime elektorale. Për të përdorur shprehjen e famshme të Oruellit, “e kaluara u fshi, fshirja u harrua, gënjeshtro u bë e vërtetë”.

Vetëvendosja, në pamundësi për të ofruar një alternativë më të mirë apo shpresë, vendosi që të mbjellë pakënaqësi, të bëjë që qytetarët të ndihen të privuar e të zhgënjyer. Kjo mund të bëhet me narrativën “rivalët politikë 20 vjet e kanë shkatërruar Kosovën” ani pse gjatë dekadës së parë të lirisë së Kosovës, qeverisja ka qenë e ndërkombëtareve. Ani pse faktikisht gjatë pesë vjetëve të para të jetës së saj politike, në qendër të kritikës së LV-së ka qenë i ashtuquajtur “sundim neokolonialo-imperialist i UNMIK-ut” si përgjegjës kryesor për gjendjen në vend, e jo partitë politike shqiptare.

Mirëpo tashmë pritshmëria e kultivuar dhe inflacionuar nga Vetëvendosja ka kapur kupën e qiellit dhe të njëjtët qytetarë që u zhgënjyen me elitën paraardhëse, po ftohen për të njëjtat arsye me elitën e re vetëvendosëse të Shën Valentinit. Gafat apo gabimet e Kurtit gjatë qeverisjes kanë qenë të shumta dhe secila prej tyre ka pasur ndikimin e vet te humbja e 2/3-ve të votave brenda një viti. Kontribuues në disfatën

zgjedhore mund të konsiderohen dështimet me menaxhimin e pandemisë, mungesa e ndihmës ekonomike për të prekurit nga pandemia, ëndërrimet tradicionale anti-amerikane; mungesa e koherencës së qëndrimeve të LV-së, zmbarsja nacionaliste duke hequr dorë nga premtimet e mëhershme për bashkim; mungesa e kurajës dhe paaftësia për t’u përballur me problemet dhe sfidat e vendit sikurse janë dialogu; paaftësia për të ndërtuar një ekip cilësor qeverisës; aferat e shumta korruptive në qeverisje lokale e qendrore të LV-së; spastrimet politike dhe emërimet partiake; gafat apo veprimet e tij naive dhe qesharake si lider sikurse qe konkurrimi elektorale në Shqipëri; mbyllja e kufirit me Shqipërinë etj. Mirëpo faktori kryesor ngelet pritshmëria e jashtëzakonshme që ka kultivuar në kuadër të viteve. Prej vitesh ka nxitur një oreks të papërmbytshëm te qytetarët për një vazhdim të shpejtë e pothuajse magjik sapo Vetëvendosja të vijë në pushtet. Qytetarët i besuan përrallës së tij, mirëpo ngelën të uritur. Tashmë duan rezultate. Duan që oreksi të përmbushet e shuhet me arritje konkrete. Sado që të investohet nga qeveria aktuale në propagandë, në ambalazh, qytetarët duan produkt. Sado të ketë servilë qeveria, që thonë se “mbreti është veshur me rroba të bukura”, gjithnjë e më shumë qytetarë po e kuptojnë se mbreti është lakuriq. Për rrjedhojë, nëse viti që iku u nis me “revolucionin elektorale” të Vetëvendosjes, viti që po vjen do të vazhdojë me “kundër-revolucionin” sepse, sikurse thoshte dikur gazetari politik Jacques Mallet du Pan për Revolucionin Francez: “Revolucioni është si Saturni, gjithmonë i ha bijtë e vet”.





# Çfarë presin njerëzit nga viti 2022?



Pas një vitit tjetër të ndikuar fuqimisht nga Covid-19, njerëzit presin me shpresë dhe padurim atë që do të sjellë viti 2022. Kjo sipas një sondazhi të ri "Global Advisor" të kompanisë Ipsos në 33 vende të botës. Nga 9 pyetjet ku ka të dhëna mbi tendencat që nga viti 2020, 4 tregojnë ndryshime domethënëse, duke treguar një pikëpamje më optimiste të njerëzve për atë do të sjellë viti 2022.

Megjithatë, vazhdojnë shqetësimet për mjedisin dhe rritjen e çmimeve. Dhe ndërsa shumica presin një nivel më të lartë të vaksinimit kundër Covid-19 në të gjithë botën, gjysma (47 për qind) presin shfaqjen e një lloji të ri vdekjeprurës të koronavirusit.

## Covid-19

Më shumë se gjysma e njerëzve (56 për qind), besojnë se brenda vitit të ardhshëm më shumë se 80 për qind e popullsisë së botës, do të marrë të paktën një dozë të një vaksine anti-Covid. Amerikano-latinët janë shumë optimistë, me shifra që shkojnë deri në 81 për qind në Peru, 76 për qind në Brazil dhe 69 për qind në Kili. Ndërkohë evropianët janë më skeptikë për shpërndarjen më të gjerë të vaksinave, ku shifrat bien në 42 për qind në Francë, 38 për qind

në Zvicër, dhe 33 për qind në Gjermani.

## Mjedisi

Shumica e njerëzve në mbarë botën, besojnë se në vitin 2022 do të shohim më shumë pasoja të ndryshimeve klimatike. 60 për qind e të anketuarve, mendojnë se vitin e ardhshëm ka të ngjarë që në vendin e tyre të ketë më shumë ngjarje ekstreme të motit, sesa në vitin që po lëmë pas.

Ndërsa disa vende evropiane u goditën rëndë nga përmbytjet këtë vit, nuk është çudi që këto shifra rriten në 72 për qind në Holandë, 69 për qind në Britani, dhe 66 për qind në Belgjikë. 45 për qind e të anketuarve, presin të udhëtojnë më pak në avion sesa në vitin 2019. Njerëzit në Azi janë më të sigurt se ka të ngjarë të ndodhë kështu, me 68 për qind në Kinë, 67 për qind në Singapor, dhe 66 për qind në Malajzi.

## Ekonomia

Një shumicë e dukshme (75 për qind) pret që çmimet në vendet e tyre të rriten më shpejt se sa të ardhurat. Ndërsa shumica e njerëzve në mbarë botën, mendojnë se kjo gjë ka të ngjarë të ndodhë, vetëm një e treta (33 për qind) mendojnë kështu në Japoni (vend që ka vazhdimisht deflacion).

Vetëm një e treta (35 për qind) në rang global, presin rrënimin e bursave në mbarë botën. Ndërkohë shumica kanë pritshmëri më të mëdha për stabilitetin e tregut të aksioneve në vitin 2022 sesa këtë vit, kur 40 për qind e të anketuarve thanë se tregjet kryesore të aksioneve në mbarë botën, kishin të ngjarë të pësonin kolaps.

## Shoqëria

71 për qind e të pyeturve, parashikojnë se qendrat e qyteteve në vendet e tyre, do të bëhen sërish të tejpolluara, pasi njerëzit do t'i rikthehen rregullisht punës në zyrë. 9 në 10 (87 për qind) në Kinë, thonë se kjo gjë ka të ngjarë të ndodhë. Ndërkohë edhe njerëzit në Amerikën e Jugut kanë pritshmëri të ngjashme me 4 në 5 prej tyre (78 për qind) në Argentinë, Brazil dhe Kolumbi.

Në nivel global, rreth 3 në 10 njerëz (28 për qind) thonë se ka të ngjarë që njerëzit në vendin e tyre, të jenë më tolerantë ndaj njëri-tjetrit. Kjo shifër është 60 për qind në Indi, ndërsa vetëm 9 për qind e francezëve, mendojnë se ka të ngjarë të ndodhë diçka e tillë.

## Teknologjia

Mbi gjysma (57 për qind) thonë se

ka të ngjarë që shumë njerëz të jetojnë në një botë virtuale. Kjo shifër rritet në thuajse 8 në 10 njerëz (77 për qind) në Turqi, por bie në 43 për qind në Britaninë e Madhe, 36 për qind në Arabinë Saudite dhe vetëm 18 për qind në Japoni.

4 në 10 njerëz (38 për qind), mendojnë se ka të ngjarë që qeveritë të vendosin rregulla strikte për kompanitë e mëdha të teknologjisë. Dhe nga Anketa jonë e Trendeve Globale 2021, ne e dimë se 83 për qind e mendojnë se kompanitë e mediave sociale kanë aktualisht shumë pushtet.

## Kërcënimet globale

4 në 10 njerëz, presin që një fatkeqësi natyrore të godasë një qytet të madh në vendin e tyre. Kjo rritet në 63 për qind në SHBA, dhe 58 për qind në Turqi. Ndërkohë, skandinavët janë më optimistë, dhe vetëm një pakicë pret që një fatkeqësi natyrore të godasë respektivisht Suedinë (24 për qind) dhe Danimarkën (21 për qind). 4 në 10 njerëz (38 për qind), mendojnë se hakerat e komanduar nga një qeveri e huaj, mund të shkaktojnë një mbyllje globale të internetit.

## Apokalipsi?

1 në 3 njerëz (34 për qind) në nivel global, mendon se ka të ngjarë që

të përdoren armët bërthamore në një konflikt diku në botë. Kjo shifër rritet në gjysmën (52 për qind) e njerëzve në Turqi. Ndërkohë 1 në 7 njerëz në total (14 për qind), pret që alienët ta vizitojnë tokën në vitin 202. Por si gjithmonë, janë indianët më të shumtët në numër, që presin vizitorë nga hapësira e jashtme.

## Viti 2022

Shpresa është në ndjenjë e përjetshme e njerëzimit. 3/4 e njerëzve (77 për qind) presin një vit më të mirë në 2022-in, duke filluar nga 54 për qind e japonezëve, që thonë se janë optimistë se viti i ardhshëm do të jetë më i mirë për ta sesa ishte 2021-i.

Kështu mendojnë edhe 94 për qind e kinezëve. Viti që po lëmë pas, dukej se ishte më i mirë se 2020-a për shumicën e vendeve. Si në shumicën e viteve, 3/4 e të anketuarve thonë se vitin e ardhshëm do të marrin disa vendime personale për të bërë disa gjëra specifike për veten apo të tjerët në vitin 2022.

Në përgjithësi ka më shumë optimizëm mbi ecurinë e ekonomisë globale. 3 në 5 njerëz në mbarë botën, bien dakord se ekonomia globale do të jetë më e fortë vitin e ardhshëm, krahasuar me vetëm 54 për qind në vitin 2020. / Ipsos.com – Bota.al



# Bota në vitin 2021 nëpërmjet fotografive të BBC-s

BBC, sjell një përzgjedhje fotografish kuptimplote të realizuara nga fotografët e agjencive të lajmeve në mbarë botën, gjatë këtij viti



Më 6 janar, mbështetësit e dhunshëm të ish-presidentit kaluan barrikadat dhe hynë në ndërtesë, ndërsa Kongresi po vërtetonte fitoren për Joe Biden.



Kamala Harris bëhet gruaja e parë me ngjyrë nënpresidente, e Azisë Jugore e SHBA-së, pasi u betua në detyrë nga gjyqtarja e Gjykatës së Lartë, Sonia Sotomayor.



Një instalacion i titulluar "Së bashku", nga Lorenzo Quinn, shfaqet pranë piramidës së Gizës, në Kajro, në tetor. Ekspozita, "Forever Is Now", shfaq skulptura rreth pllajës së Gizës, me vepra nga artistë bashkohorë egjiptianë dhe të huaj.



Anëtarët e familjes së Vijay Raju, i cili humbi jetën nga koronavirusi, vajtojnë në një krematorium në fshatin Giddenhalli, në periferi të Bengaluru, Indi, në maj.



Një fëmijë tregon një tullumbace në Karaçi, Pakistan, pas lutjeve të Fitër Bajramit, duke shënuar fundin e muajit të shenjtë të Ramazanit, në maj.



Ekipe të kërkimit dhe shpëtimit punojnë në vendin e një kompleksi apartamentesh 12-katëshe të shembur në Surfside, pranë Miamit në Florida, ku mbetën 98 viktima më 24 qershor. Një pjesë e mbetur e bllokut të apartamenteve u shkatërrua në fillim të korrikut, për shkak të pasigurisë. Shkaku i shembjes është ende nën hetim.



Gorilla jetime, Ndakasi, shtrihet në krahët e kujdestarit të saj, Andre Bauma, pak para se të humbte jetën, në shtator, në Virunga – parku kombëtar më i vjetër i Afrikës – në Republikën Demokratike të Kongos. Z. Bauma e shpëtoi Ndakasin dymuajshe, në vitin 2007, pasi gjuetarët pa leje vranë prindërit. Rojtarët vendosën se ishte shumë e pasigurtë në natyrë dhe kështu, e rritën atë në kopshtin zoologjik.



Imam Aleksander Bazarewicz thotë një lutje gjatë ceremonisë së varrimit të një refugjati sirian 19-vjeçar, Ahmed, i cili u mbyt në lumin Bug, duke u përpjekur të shkonte në Poloni, në nëntor. Ceremonia u zhvillua në varrezat lokale të një komuniteti të vogël mysliman në Bohoniki.



Turmat festojnë verdiktin fajtor të ish-oficerit të policisë së bardhë Derek Chauvin, jashtë Qendrës Qeveritare të Qarkut Hennepin, në Minneapolis, SHBA, në prill. Juria e shpalli Chauvin, fajtor për tre akuza për vrasjen e George Floyd: vrasje të shkallës së dytë, vrasje të shkallës së tretë dhe vrasje nga pakujdesia.





Zëvendës-sekretarja e shtypit Karine Jean-Pierre, u bë gruaja e parë me ngjyrë në 30 vjet, që organizoi një konferencë të përditshme për shtyp në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, SHBA, në maj. “Është një nder i vërtetë të jesh këtu”, – tha ajo. “Por unë besoj se të qenit pas këtij podiumi, të qenit në këtë ndërtesë, nuk ka të bëjë me personin; ka të bëjë me atë që ne bëjmë në emër të popullit amerikan.”




Infemieri që shkon në çdo shtëpi, i injektun një gruaje vaksinën AstraZeneca Covid-19 në Siaya, Kenia, në maj.



Qindra afganë hipin në bordin e një aeroporti të ngarkesave ushtarake amerikane, ndërsa largohen nga Kabuli pas pushtimit të vendit nga talebanët, në gusht. Uebfaqja amerikane e analizave të mbrojtjes “Defence One”, raportoi për një zyrtar amerikan që kishte thënë “ekuiपाझhi kishte vendosur se ishte më mirë të ngrihej, sesa t’i detyronte njerëzit të largoheshin nga avioni”.



Në gusht, Julio Cesar La Cruz nga Kuba, pozoi pasi fitoi boksën e peshave të rënda për meshkuj në Lojërat Olimpikë Tokio 2020.




Sipërfaqja e Marsit e parë nën roverin Mars Perseverance, në shkurt. NASA ndau qindra imazhe të planetit, ndërsa roveri filloi misionin për të gjetur shenja jete të hershme dhe për të mbledhur mostra, për një kthim të mundshëm në Tokë.




Pjesa e brendshme e një shtëpie të dëmtuar nga tornadoja në Mayfield, Kentaki, SHBA, në dhjetor. Tornadot pushtuan vendin dhe zyrtarët, theksuan se ishin më shkatërruesit në historinë e Kentakit. Janë raportuar më shumë se 70 viktima.



Dy astronautë me kostume hapësinore marrin pjesë në një mision në Kraterin Ramon në shkretëtirën Negev të Izraelit, i projektuar për të ndihmuar në përgatitjen për uljen e ardhshme në Mars, në tetor. Forumi Austriak i Hapësinës dhe Agjencia Hapësinore e Izraelit, po bashkëpunojnë në misionin trijavor.



Ajsbergët shihen në grykën e fjordit të akullit Jakobshavns, gjatë perëndimit të diellit, pranë Ilulissat-it, Groenlandë, në shtator.



Matt Stutzman, nga SHBA, i njohur si “shigjetari pa krahë”, konkurren kundër Marcel Pavlik të Sllovakisë, në garën individuale të komponimit të harkut për meshkuj, në Lojërat Paralimpikë Tokio 2020, gusht.



Vullnetarët vendas mblidhen në një fushë të hapur dhe presin të mbështesin zjarri-frikësit gjatë një zjarri pranë fshatit Kamatriades, ishulli Evia, Greqi.



Reperi amerikan Lil Nas X, në Met Gala 2021 – një nga ngjarjet më të mëdha dhe më me yje të modës – në Muzeun Metropolitan të Artit në Nju Jork, në shtator. Gala u rikthye pas anulimit vitin e kaluar, për shkak të pandemisë.



# Shtetet më të mira për të punuar jashtë vendit në vitin 2022

Pandemia ka ndryshuar tërësisht jetën tonë, nga gjërat më të vogla të përditshmërisë e deri te mendimet për të punuar diku gjetkë nëpër botë.

Me kaq shumë industri që po kalojnë online, puna në distancë mund të jetë në favorin tuaj. Për të patur një ide në lidhje me vendet më të mira për emigrantët, i

referohemi studimit të vitit 2021 të Expat Insider, bazuar te anketimi i mijëra emigrantëve në mbarë botën.



## Tajvani

Tajvani u rendit në vendin e parë në Indeksin e Punës Jashtë Vendi. Të anketuarit ishin të kënaqur me sigurinë e punës - 83% ishin përgjithësisht të kënaqur, në kontrast me 61% në nivel ndërkombëtar. Shumica e të anketuarve ishin të kënaqur me orët e tyre të punës (74%) ndërsa dy në pesë nuk mund të jenë më të lumtur me punën e tyre - që është gati dyfishi i mesatares ndërkombëtare.

## Zelanda e Re

Zelanda e Re u rendit në vendin e dytë, ndërsa Republika Çeke e treta. Nëse pëlqeni një jetë nomade, Republika Çeke mund të jetë vendi i duhur pasi 93% e amigrantëve thanë se mund të punojnë në distancë.



## Republika Çeke

Renditja e vendeve të tjera në

Top10 vijon kështu:

4. Kina
5. Danimarka
6. Gjermania
7. Austria
8. Irlanda
9. Vietnami
10. Australia





# +10 gjëra që supersticiozët thonë se duhet t'i bëni natën e Vitit të Ri për fat të mirë!



1.

Sirtaret, frigoriferi dhe e gjithë shtëpia duhet të jenë të mbushura!

2.

Lini dyert hapur. Thuhet se duke bërë kështu, do të nxirrni jashtë gjithë energjinë e keqe!

3.

Pastroni shtëpinë, për një fillim të ri. Me siguri kjo s'është e nevojshme për t'u listuar sepse askush më shumë se mamatë shqiptare s'i ka fiksuar "punët e Vitit të Ri".

4.

Mbani një valixhe të hapur gjatë mbrëmjes së 31 dhjetorit nëse doni të udhëtoni më shumë!

5.

Vishni të brendshme të kuqe nëse doni fat të mirë dhe suksese përgjatë vitit.

6.

Puthni dikë në mesnatë. Besohet se duke bërë këtë, shanset për romancë në muajt e ardhshëm janë shumë të larta.

7.

Mos nxirr asgjë jashtë shtëpisë pas mesnatës dhe para 2 janarit. Madje, mos derdhni as plehurat. Besohet se duke bërë të kundërtën, padashje mund të "flakni tutje" fatin e mirë që keni mbledhur." As tryezën e Vitit të Ri mos e pastroni atë mbrëmje.

8.

Bëni kujdes me njerëzit që fusni të parët në shtëpi. Sigurohuni të mos vijnë duarbosh dhe përgjithësisht të konsiderohen si të mbarë.

9.

Bëni pak zhurmë pas orës 12:00.

10.

Hani 12 kokrra rrushi në mesnatë.

11.

Keni ditëlindjen me 1 janar? Konsiderohet fat i mirë, kështu që merrni frymë thellë!

12.

Vishni diçka me pika, nëse doni më shumë para këtë vit.

13.

Mos harroni shampanjën! Hapeni ju!



# Cila është koha më e favorshme për dasma në 2022?

Me Vitin e Ri, vjen koha për të marrë vendime të reja në jetën tonë. Jam e sigurt që shumë prej jush janë të emocionuar për të hyrë në një kapitull të ri në jetën tuaj. Por përpara se të fillojmë t'i përgjigjemi 'kur', le të vlerësojmë 'pse'.

Ka katër objektiva kryesore të ndjekjes së jetës njerëzore në Indi, Dharam (drejtësia, vlerat morale), Arth (prosperiteti, vlerat ekonomike), Kaam (kënaqësia, dashuria, vlerat psikologjike) dhe Moksha (çlirimi, vlerat shpirtërore).

Ndër 4 vlerat që janë përmendur më sipër, martesë është e treta (vlera) e parafundit. Institucioni i martesës siguron që një person të jetë përgjegjës dhe të merret parasysh nga një person tjetër. Është kështu që duke bashkuar duart dhe kokat e tyre së bashku, ata mund të kapërcejnë dobësitë e tyre individuale dhe të bëjnë një jetë të ekuilibruar.

Duket e pamundur ta ngasësh jetën, por një person që ka zotëruar aftësinë e ekuilibrit dhe kontrollit mund ta kalojë lehtësisht. Në mënyrë të

ngjashme, një person me vullnet dhe mendje të fortë është i aftë të kalojë me hijeshi udhëtimin e jetës. Kështu që bëhuni gati sepse ne do t'ju tregojmë cilët janë muajt më të mirë për martesë në vitin 2022.

Sipas parashikimeve, koha më e mirë për martesë në vitin 2022 është midis muajve janar dhe korrik.

Nga data 10 korrik deri më 4 nëntor të këtij viti, ne do të jemi dëshmitarë të 'Chatur Maas' ose periudhës 4 mujore në të cilën thuhet se Zoti ka hyrë në gjendjen e 'Yoga Nidra'. Këshillohet që në këtë periudhë të mos bëhen dasma. Muaji Nëntor gjithashtu nuk këshillohet për martesë pasi Afërdita do të shkojë poshtë horizontit.

Përveç arsytimit të mësipërme, periudha e lartpërmendur është koha e ndryshimit të stinëve. Ndryshimet e motit synojnë lehtësisht sistemin tonë imunitar dhe tretjen, duke na bërë të prirur ndaj infeksioneve dhe sëmundjeve. Kjo sugjeron logjikisht pse duhet të shmangni festimet e tyre në këtë hark kohor.



## 6 çifte VIP që u bashkuan në 2021

2021 ishte një vit i ndërlikuar për shumë çifte, por për të tjerë ishte viti fitues. Ishin të shumtë VIP-at që u takuan, të dashuruar dhe të fejuar, dhe në këtë artikull do t'ju tregojmë disa nga çiftet që u krijuan gjatë këtij viti!



Zendaya dhe Tom Holland



Adele dhe Rich Paul



Jennifer Lopez - Ben Affleck



Kim Kardashian - Pete Davidson



Olivia Wilde - Harry Styles



Kourtney Kardashian - Travis Barker





*Januar 2022!*

www.epokaere.com

# SPORT

## Khudoja, krenaria e Kosovës, sjell dy medalje të arta olimpike

**EPOKA E RE** Përgatiti: **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, DHJETOR** - janar - Sporti i xhudos në krye me trajnerin legjendar Driton Kuka vazhdon të jetë krenaria e sportit dhe shtetit të Kosovës pasi sukseset e saj janë të paarrtshme edhe nga shumë shtete të mëdha evropiane dhe botërore. Në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", Distria Krasniqi dhe Lorian Kuka kanë fituar medaljet e arta në kategoritë -48 kg, përkatësisht -57 kg, kurse janë siguruar nga Kosova edhe dy vende të shtata. Ndërsa Majlinda Kelmendi dhe Akil Gjakova nuk arritën të japin më të mirën dhe të sigurojnë medalje. Mundja dhe boksi i Kosovës u përfaqësuan për herë të parë në Lojërat Olimpikë, kurse Kosova në këto lojëra u përfaqësua me gjithsejtë 11 sportistë, prej tyre gjashtë me normë olimpikë (xhudistët dhe mundësit) që vlerësohet sukses i jashtëzakonshëm për ekipin e Kosovës.

Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe trajneri Driton Kuka janë pritur në mënyrë madhështore e me ceremoni shtetërore nga shteti i Kosovës. Në shesh para publikut ka folur kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, për kampionet olimpikë të Kosovës. "Tri medalje të arta, nga tri gra, kjo fjalë me shtatë fjalë, faleminderit vazhde, faleminderit trajnerëve dhe secilit që ka ndihmuar. Tani le të fillojnë përgatitjet për në Paris dhe të fitojmë edhe më shumë medalje", ka thënë Kurti, i cili e ka vlerësuar lart medaljen e parë të fituar nga Majlinda Kelmendi në Lojërat Olimpikë "Rio 2016", duke thënë se Majlinda do të mbetet kampione përjetë. "Në olimpiadën e parë Majlinda i solli Kosovës medaljen e parë të artë në Rio, kurse në atë të Tokios, Distria dhe Nora i sollën vendit dy. Medaljet e arta, aq sa kërkojnë talentë, kërkojnë edhe mund", ka shtuar Kurti. Ndërsa për trajnerin Driton Kuka, Kurti ka thënë se xhudon e ka bërë sinonim të fitores. "Aq sa kërkon talent, kërkon disiplinë, teknikë e taktikë

të përsosur, me këmbëngulje e ka bërë xhudon sinonim të fitores", ka deklaruar Kurti.

**Majlinda Kelmendi pensionohet me ceremoni shtetërore, i jepet urdhri 'Shote Galica'**



Me ceremoni shtetërore të organizuar nga presidentja e shtetit, Vjosa Osmani, heroina e Kosovës, Majlinda Kelmendi, i ka dhënë fund karrierës prej xhudistes. Kampionja olimpikë, krahas Medaljes së Artë Olimpikë të fituar në Rio 2016, karrierën e mbylli edhe me tre tituj kampioni (dy si seniore dhe një si juniore), katër medalje të arta evropiane, përfshirë Lojërat Evropiane Minsk 2019, një medalje të bronzitë botërore dhe e shpallur tri herë xhudistja më e mirë në botë. Në ceremoninë e organizuar në Institutin "Ali Hadri" në Prishtinë, presidentja Osmani i ka dhënë urdhrin "Shote Galica". "Ajo me të drejtë cilësohet legjendë e sportit të xhudos. Me të drejtë konsiderohet heroinë e Kosovës. Me tri dekada të jetës së saj, Majlinda u bë fytyra e Kosovës së sotme, që e bëri shtetin tonë të tillë çfarë e duam. Flamuri kaltër e verdhë valoi majave karshi flamujve të shteteve më të mëdha anekënd globit fal Majlindës", ka thënë Osmani. Ndërsa Majlinda Kelmendi, e cila tani e tutje do ta vazhdojë karrierën e trajneres, ka folur për fillimin e karrierës, për sfidat nëpër të cilat ka kaluar derisa ka arritur sukseset më të mëdha që arrihen në sport. "Jam rritur me Tonin si garuese e Toni është rritur me mua si trajner. Për



shumë vite kemi qenë unë dhe ai kundër krejt botës dhe i kemi treguar se sa shumë vlera kemi ne populli i Kosovës. Kur Toni filloi të fliste për mua kur isha 15-vjeçare, të fliste për medalje olimpikë, shumë e quanin të çmendur se po sheh ëndrra me sy çel. Sot ai është trajneri më i mirë në botë me tri medalje të arta olimpikë nga një shtet i vogël si Kosova", ka thënë 30-vjeçarja. "Falënderimi special shkon për Disin. Kemi qenë sparring partnere për 13 apo 14 vjet. Ka mjaftuar me zgjatë njëjërë dorë dhe ajo e ka ditur se çfarë dua të ushtroj e punoj. Ka qenë sparrinet partnerja ime dhe tash është kampione aktuale olimpikë e realisht për mua aktualisht xhudistja më e mirë në botë. Falënderim shumë i madh nga zemra shkon për vendin tim, për popullin tim që më ka përkrahur gjithmonë pa kusht. E di se unë jam për ju heroinë, e di se me krahasoni me Nënë Terezën apo Adem Jasharin, por besoni motivi më i madh për të arritur këtu jeni ju. Kam punuar gjithmonë 200 për qind, kam dhënë më shumë se maksimumin prej vetes, mos me t'ju zhgënjëj e t'ju bëj krenar. Shpresoj shumë se ia kam arritur. Shpresoj shumë se ju kam bërë krenar, ju kam sjell lot gëzimi e në çaste të caktuara edhe lot hidhërimi. Ishte nder, krenari e privilegj shumë i madh për mua t'ju përfaqësoj ju, populli im. Jam mirënjohëse deri në frymën time të fundit dhe jua dua pa fund", ka deklaruar Kelmendi, e cila ka qenë tri herë pjesëmarrëse në Lojërat Olimpikë. Në Londra 2012 përfaqësoi Shqipërinë, ndërsa në "Rio 2016" dhe "Tokio 2020" Kosovën. Në Rio dhe Tokio ishte edhe bartëse e flamurit në ceremoninë hapëse.

**Majlinda shpallet 'qytetare me merita të veçanta'**

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar propozim-vendimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shpalljen e Majlinda Kelmendit "qytetare me merita të veçanta". Konsideruar

kontributin që ajo ka dhënë për promovimin e fushës së sportit në Kosovë dhe për promovimin e shtetit tonë në arenën ndërkombëtare, Majlinda Kelmendi merr statusin e qytetares me merita të veçanta dhe do të shpërblehet në vlerë prej 1,321.32 eurosh në muaj, e cila përkon me rrogën bruto të një Ministri/e në Kosovë.

**Kuka dhe Krasniqi, më të mirët në botë**

Driton Kuka dhe Distria Krasniqi e kanë mbyllur edhe me një tjetër sukses vitin 2021. Trajneri Kuka është shpallur për herë të parë trajneri më i mirë në botë, kurse ai ka thënë se ky çmim shkon për Kosovën, vendin tonë të vogël, por me njerëz të mrekullueshëm. Pas Kukës, kampionja olimpikë "Tokio 2020", Distria Krasniqi, u zgjodh "Xhudistja më e mirë femër për vitin 2021". Disi kishte marrë më së shumti vota, ndërsa në top 5 ishte nominuar falë suksesit në Rio dhe bërjes kampione e Evropës. Pas marrjes së çmimit ajo ka thënë se nuk e kishte pritur se do të jetë e para, por është çmimi që e bën të ndihet krenare.

**Përurohet Qendra Nacionale e Xhudos**

Tri medalje Kosova i fitoi në Lisbonë të Portugalisë. Xhudisti Akil Gjakova është bërë për herë të parë kampion

i Evropës në xhudo për sendorë në Kampionatin Evropian. Laura Fazliu e zuri vendin e pestë në kategorinë deri në 63 kilogramë. Medaljen e artën e fitoi edhe Distria Krasniqi, kurse Nora Gjakova u stolis me të bronzitën. Laura shënoi tri fitore, ndërsa pësoi humbje në çerekfinale dhe në luftën për të bronzitën. Laura Fazliu ka fituar medaljen e bronzitë në garën e "European Open", që po mbahet në Zagreb të Kroacisë. Ndërsa Shpati Zekaj ka fituar medaljen e parë për seniorë në garat ndërkombëtare. Zekaj fitoi të argjendtën në "European Open", që u mbajt në Zagreb të Kroacisë. Nora Gjakova është stolisur me medaljen e bronzitë të botës në Kampionatin Botëror të Xhudos në Budapest të Hungarisë.

**Medaljet nuk munguan edhe nëpër garat e tjera**

Një e artë dhe dy të bronzta është bilanci i medaljeve të fituara nga ekipi Olimpik i Xhudos, në ditën e parë të garës së Mastersit që u mbajt në Doha të Katarit. Distria Krasniqi fitoi medaljen e artë në kategorinë deri në 48 kilogramë, Majlinda Kelmendi (-52 kg) e Nora Gjakova (-57 kg) fituan të bronzitën. Lorian Kuka në Doha të Katarit ia siguroi Kosovës medaljen e katërt. Lorian ia siguroi medaljen e bronzitë në kategorinë deri në 78 kilogramë. Kampionja Olimpikë, Majlinda Kelmendi, ka fituar medaljen e bronzitë në Grand Slamin e xhudos në Tel Aviv të Izraelit. Në mars xhudistja Nora Gjakova ka fituar medaljen e artë në Grand Slamin e xhudos në Tbilisi të Gjeorgjisë. Laura Fazliu ka fituar medaljen e bronzitë në Grand Prixin e xhudos që po mbahet në Zagreb të Kroacisë. Erza Muminoviq ka fituar medaljen e bronzitë të botës në Kampionatin Botëror të Juniorëve (U-21) që po mbahet në Olbia të Italisë. Flaka Loxha ka fituar medaljen e bronzitë në Kampionatin Evropian të U-23 të Xhudos që u mbajt në Budapest të Hungarisë.





# As në vitin e dytë të Covidit sporti s'u dorëzua

**EPOKA ERE** Përgatiti: Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, DHJETOR** - janar - Sporti në të gjithë botën arriti që për të vitin e dytë radhazi t'i bëjë pallë pandemisë Covid-19 ani pse shpesh virusi nxori telashe nëpër klube duke bërë të pamundur që të gjithë lojtarët të janë të gatshëm për aktivizim. Megjithatë, ngjarjet interesante përgjatë këtij viti nuk munguan si në rrafshin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Përfaqësuesja e Kosovës e mbylli ciklin kualifikues për Botërorin "Katari 2022" në vendin e parafundit, duke e bërë një fushë mjaft zhgënjyese që i kushtoi me shkarkim edhe trajnerit Bernard Challandes. Ndërsa Hajrulla Çeku është emëruar ministër i Sportit, duke qenë mjaft aktiv për kohën që është në krye të këtij dikasteri. Në basketboll, KB Ylli dominoi në Superligë duke fituar titull, por njëherësh e fitoi edhe Ligën Unike që u organizua për herë të parë. Në hendboll Besa Famgas dominoi, kurse Prishtina iu rikthye titullit pas tetë vjetësh. Kupën dhe Superkupën e fitoi skuadra e Llapit, e cila fitoi të drejtën të dalë për herë të parë në garat ndërkombëtare. Në rrafshin ndërkombëtar, Italia e fitoi Kampionatin Evropian, ku në finale e mposhti Anglinë. Piloti Max Verstappen e ndali dominimin e Hamiltonit, duke qenë fitues i kampionatit të Formulës 1. Ndërsa skuadra e Chelsea e fitoi Ligën e Kampionëve, duke triumfuar në finale ndaj Manchester Cityt.



Hajrulla Çeku emërohet ministër i MKRS-së

## Hajrulla Çeku emërohet ministër i MKRS-së

**22 mars** - Në muajin mars Hajrulla Çeku ka pranuar detyrën e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Detyrën e ministrit Çekut ia dorëzoi zëvendësministri i i Kulturës, Engelbert Zefaj. Çeku është emëruar ministër i MKRS-së ditën e hënë kur qeveria në krye me Albin Kurtin është votuar nga 67 deputetë në Kuvendin e Kosovës.

## Krasniqi zgjedhet president i ri i KOK-ut

**26 mars** - Ismet Krasniqi është zgjedhur president i ri i Komitetit Olimpik të Kosovës në Asambleenë e 8 Zgjedhore. Krasniqi fitoi me 53 vota kundrejt dy kundërkandidatëve të tij, Besim Hasanit, që mori 41 vota dhe Linda Shalës, 11 sosh. Nënpresident i parë u zgjodh Gazmend Maxhuni nga triatloni, i cili mori 58 vota, nënpresident i dytë Milaim Kelmendi nga skitaria me 49 vota, nënpresident e tretë u zgjodh Mimoza Shkodra Bislimi nga volejboli dhe i katërt, Eugen Saraqini nga hendbolli.

## KB Ylli fiton titullin në Ligën Unike dhe Superligën e Kosovës

**14 prill** - KB Golden Eagle Ylli është shpallur kampion në edicionin e parë dhe historik të Ligës Unike. Skuadra suharekase ka mposhtur në finale Pejën në një ndeshje që kampioni u mësua vetëm në çastet e fundit të ndeshjes. Finalja e zhvilluar në palestrën "Dhimitraq Goga" në Durrës ka përfunduar me rezultatin 79-82. Erjon Kastrati ishte më meritori në këtë fitore të Yllit, duke shënuar 21 pikë. Ai u ndihmua edhe nga Mitchel Wilbekin që shtoi 18 pikë të tjera. Te Peja u dallua AJ Walton që shënoi 25 pikë. Skuadra e yllit e ka fituar edhe titullin e kampionit edhe në Superligën e Kosovës në basketboll. Në finale Ylli e mposhti skuadrën e



Prishtina pas tetë vjetësh rikthen titullin. Llapi fiton Kupën dhe Superkupën

barazimi, të dyja ndaj ish-kampiones së botës, Rumanisë, vlerësohet sukses, duke ditur se para hedhjes së shortit llogaritet kombëtarja më e dobët.

## Prishtina pas tetë vjetësh rikthen titullin. Llapi fiton Kupën dhe Superkupën

**13 maj** - FC Prishtina fiton matematikisht titullin kampion në Kosovë për herë të 11-të në histori. Skuadra "bardhekaltër" e siguroi titullin një javë para fundit falë fitores 1-2 në fushën e Gjilanit (shënuar në pjesën e parë Mici me penallti dhe Zyba, ndërsa golin e gjilanasve e realizoi në fraksionin e dytë Arbër Çyrbja). Kryeqytetasit rikthehen te titulli kampion pas plot tetë vjetësh. Skuadra e Llapit fiton për herë të parë në histori Kupën e Kosovës, pasi e mposhti Dukagjinin pas penalltive. Koha e rregullt përfundoi 0-0, ndërsa në vazhdime Merlaku shënoi për skuadrën nga Klina e, në anën tjetër, për llapjanët realizues ishte Prençi. Në penallti Llapi fitoi me rezultat 5-4. Llapi e fitoi edhe Superkupën.



Besa fiton titullin dhe Kupën te meshkujt. Vushtrria kampione, Istogu fitues i Kupës te femrat

## Besa fiton titullin dhe Kupën te meshkujt. Vushtrria kampione, Istogu fitues i Kupës te femrat

**15 maj** - Besa Famgas ka vazhduar dominimin e plotë në Superligën e Kosovës në hendboll. Besa e fitoi titullin e kampiones për edicionin 2020/2021. Skuadra pejane i ka fituar të gjitha ndeshjet e këtij kampionati, duke përfshirë ato të "play off"-it. Në finale të "play off"-it Besa Famgas ishte më e mirë se Prishtina. Derisa ndeshja e parë, e luajtur të shtunën në Pejë, ishte me rivalitet, të mërkurën në kryeqytet pejanët kanë dominuar plotësisht. Në fund kanë fituar me rezultat të thellë 39:32. Për Besën është titulli i tetë rresht i kampiones. Prej pavarësimit të hendbollit të Kosovës, Besa ka fituar 17 tituj të kampionit. Klubi pejan dominimin e vazhdoi edhe në garën e Kupës, pasi në finale e mposhti Prishtinën me rezultatin 38:29. Te Besa lojtari më i mirë i ndeshjes u shpall spanjollit Victor Alonso. Ai ndeshjen e mbylli me 8 gola. 8 gola i shënoi edhe Egzon Gjuka, ndërsa kapiteni Nikolla Prce e mbylli ndeshjen me

7 gola. Te Prishtina lojtar i ndeshjes ishte portieri Armir Agushi. Lojtari më i mirë i Final 4 ishte Deniz Terziqi. Ai finalen e mbylli me 13 gola, ndërsa në Superligën e femrave Vushtrria e fitoi titullin e kampiones pasi e mposhti Istogun me rezultat 22:21 në ndeshjen e tretë të finales së "play off"-it. Golin e fitores e shënoi Donita Kasumi, ndërsa skuadra e Istogut është fitues i Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll. Skuadra istogase në finale e mposhti Prishtinën me rezultat 31:23. Kapitenia Albina Rugova y shpall lojtarja më e mirë te Istogu. Te Prishtina më e mira u shpall Aida Stagova.

## Nishevci, medalist i bronzë i Evropës

**22 maj** - Herolind Nishevci ka fituar për herë të parë medalje evropiane. Karateisti i Kosovës fitoi të bronzën në Kampionatin Evropian të Karatesë që u mbajt në Poreç të Kroacisë. Nishevci në luftën për medaljen e bronzë mundi Asiman Gurbanli të Azerbajxhanit, kategoria plus 84 kilogramë. Deri te medalja Herolindi erdhi pas katër fitoreve, dy të shënuara në repesazh. Medalja e bronzë është e dyta më e madhe pas të bronzës të fituar në Kampionatin Botëror të Linz të Austrisë në vitin 2016.

## Interi, City, Bayerni, Atletico dhe Lille, kampione në ligat më të forta evropiane

**23 maj** - Skuadra e Interit e fitoi titullin e 19 në Itali. Interi shpallet kampion pas 34 ndeshjeve, ku ka arkëtuar 82 pikë, 13 sosh më shumë se vendi i dytë dhe i tretë, respektivisht Atalanta dhe Milani. Në Gjermani, Bayern Muncheni





Italia, kampione e 'Euro 2020'

e vazhdon dominimin, duke konfirmuar edhe një herë se është i pakonkurrencë në këtë ligë. Në Angli, Manchester City e riktheu titullin, duke qenë skuadra më e mirë gjatë gjithë sezonit. Në Spanjë, Atletico Madridi e fitoi titullin duke fituar me përmbysje në ndeshjen e fundit kundër Valladolidit (1-2). Në Francë, Lille i ka dhënë fund dominimit të PSG-së, që kishte fituar tre titujt e fundit. Lille fitoi si mysafir në përballje me Angersin (1-2) dhe e siguroi titullin me 83 pikë, një më shumë se Paris Saint-Germaini.

**Pesë medalje për garuesit e bodybuildingut dhe fitnessit në Ballkanikun e Rumanisë**

**13 qershor** - Përfaqësuesja e Kosovës në bodybuilding dhe fitness ka fituar pesë medalje, prej tyre tri të arta dhe të dy të argjendta në Kampionatin Ballkanik për Seniorë dhe U-20 në Severin të Rumanisë. Medaljet e arta për seniorë i fituan Kushtrim Bajraktaraj, në kategorinë bodybuilding -80 kg, Granit Kuleta-90 kg dhe Arton Koci në "Classic" -



Chelsea fiton Ligën e Kampionëve, Villarreali Ligën e Evropës

**Chelsea fiton Ligën e Kampionëve, Villarreali Ligën e Evropës**

**29 maj** - Chelsea fitoi Ligën e Kampionëve për edicionin 2020/21, pasi në finale e mposhti skuadrën e Manchester Cityt me rezultat 1-0. Golin e vetëm e shënoi Havertz, i cili merr një top fantastik nga Mount, driblon portierin dhe më pas e dërgon topin në rrjetë. City u mundua të reagojë në fillimin e pjesës së dytë, por e kishte të vështirë krijimin e aksioneve të rrezikshme dhe ndeshja përfundoi me rezultat 1-0. Ky ishte trofeu i dytë në histori të Chelseat. Ndërsa fitues i Ligës së Evropës ishte Villarreali që e mposhti Manchester Unitedin në finale, pas ekzekutimit të penalltive (11-10). Koha e rregullt dhe vazhdimet janë mbyllur me rezultat 1-1. Golin e parë e shënoi Gerard Moreno, kurse në pjesën e dytë Edison Cavani e barazoi rezultatin në 1-1. De Gea e humbi penalltinë e 11 për Unitedin dhe Villarreali e fitoi trofeun.

1.80 cm. Bajraktaraj fitoi edhe Kupën në kategorinë absolute, duke u shpallur garuesi më i mirë. Medalja e argjendte në kategorinë "Physique" -175 cm shkoi për Pllumb Latifin. Në grupmoshën U-20, të argjendtën e fitoi Fatlind Kërçeli, kategoria "Physique".

**Gazetarët sportivë fituan turneun për Javën Olimpikë**

**22 qershor** - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) organizoi turneun e futbollit të madh, aktivitet ky që u mbajt në kuadër të Javës Olimpikë 2021. Pjesëmarrëse ishin ekipet e KOK-ut, Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport, veteranët e futbollit, gazetarët sportivë dhe estrada. Turneun e fituan gazetarët sportivë të cilët në finale mundën Komitetin Olimpik të Kosovës me rezultat 5:0. Humbja e energjisë nga dy ndeshjet paraprake bëri që lojtarët e KOK-ut të mos tregojnë paraqitje të njëjtë si në takimet e tjera.

**Italia, kampione e 'Euro 2020'**

**11 korrik** - Italia e ka fituar Kampionatin Evropian "Euro 2020", pasi në finale e mposhti Anglinë pas ekzekutimit të penalltive. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat 1-1 falë golave të Luke Shaw dhe Leonardo Bonucci. Në ekzekutimin e penalltive më të saktë u treguan "Azzurrët" (3-2).

**Ramadani, kampion evropë U-20 në hedhjen e gjyles**

**16 korrik** - Muhamet Ramadani është bërë kampion i Evropës U-20 në evropianin që u mbajt në Talin të Estonisë. Ai e fitoi medaljen e artë në hedhjen e gjyles 6 kilogramë. Rezultati më i mirë i tij në finale ishte 19.92 metra. Ai la kundërshtarët prapa për më shumë se gjysmë metri. Është kjo medalja e parë historike për atletikën e Kosovës në kampionate evropiane. Më herët Ramadani kishte fituar medaljen e artë në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj Baku 2019.

**Pas 50 vjetësh, Milwaukee shpallet kampion në NBA**

**21 korrik** - 50 vjet pritje për ta festuar titullin në NBA. Milwaukee Bucks siguron trofeun e dytë në histori dhe këtë e bën falë legjendës Giannis Antetokounmpo i cili shkëlqeu në finale përballë Phoenix Sunsit duke realizuar 50 pikë. Vetëm 5 basketbollistë të tjerë kanë pasur një performancë të tillë në një finale në historinë e NBA-s. Milwaukee Bucks triumfoi 4-2 në finale duke mbyllur përpara kohe sfidën e madhe me Sunsib. Në finalen e fundit, atë të gjashtë, Bucks ishte dominues duke e mbyllur në fund me shifrat 105-98. Perioda e parë përfundoi 29-16 në favor të Bucksit, por miqtë rihapën sfidën duke bllokuar sulmin e vendasve që në periodën e dytë shënuan vetëm 13 pikë. Ishte greku Antetokoumpo që shpërtheu në të tretën duke realizuar 20 pikë personale duke mbajtur Milwaukee në avantazh. Historia nuk ndryshoi as në periodën e katërt dhe të fundit, me Antetokoinmpo që ishte i papërmbajtshëm duke u shpallur në fund edhe lojtari më i mirë i finales.

**Messi dhe Ramosi bashkohen në PSG, Ronaldo rikthehet në United**

**Messi dhe Ramosi bashkohen në PSG, Ronaldo rikthehet në United**

**10 gusht** - Atë që nuk e priste askush ndodhi në vitin 2021, kur Lionel Messi u largua nga Barcelona dhe iu bashkua Paris Saint-Germainit. Ylli argjentinas firmosi për dy vjet me skuadrën franceze, por me mundësi të vazhdimisht edhe për një vit tjetër. Nuk kishte pritur thujt askush që 34-vjeçari të ndahej me Barcelonën, por rregullat e La Ligas dhe gjendja financiare e klubit ndau rrugët. Tani Messi është te Parisi dhe klubi francez do të fitojë miliona tifozë të tjerë nëpër botë. Kjo nuk ishte e tëra për faktin se PSG-ja e transferoi edhe kapitenin legjendar të Real Madridit, Sergio Ramos. Një transferim i madh ishte edhe ai i Cristiano Ronaldos, i cili e la Juventusin dhe u rikthye në klubin ku bëri emër, Manchester United.

**Taekwondisti Jon Gashi fiton medaljen e artë në Kupën e 6-të Presidenciale të Evropës për të Rinj**

**21 shtator** - Taekwondisti Jon Gashi ka fituar medaljen e artë në Kupën e 6 Presidenciale të Evropës për të Rinj, të mbajtur në Stamboll të Turqisë. Gashi fitoi katër luftëra në kategorinë e kadetëve +65 kilogramë. Paraqitje mbresëlënëse pati edhe Denis Bllaca, i cili fitoi tri luftëra për juniorë, kategoria -59 kg, për t'u ndalur në çerekfinale. Denis fitoi kuotën për pjesëmarrje në Evropianin U21, kategoria Olimpikë për të Rinj. Pjesëmarrës ishte edhe Elion Agushi, që u ndal

në luftën e parë, grupmosha juniorë, kategoria -55 kg.

**Usky mposhti Joshuan, shpallet kampion bote**

**26 shtator** - Oleksandr Usyk ka shënuar një nga befasishtë më të këndshme në boks, duke fituar titujt e unifikuar botërorë IBF, WBO dhe WBA, pasi mposhti me pikë pas 12 rundeve tashmë ish-kampionin Anthony Joshua në kategorinë e peshave të rënda. Boksieri ukrainas e nisi furishëm meçin dhe fitoi tri rundet e para, më pas Joshua u këndell dhe ishte më i mirë në raundin e katërt dhe të pestë. Por nga rundi i shtatë, Usyku dominoi në meç dhe fituesi në fund nuk ishte i diskutueshëm, pasi 34-vjeçari fitoi me shumicën e pikëve nga gjyqtarët. Për Joshuan, kjo është humbja e dytë në karrierë profesionale, ndërkaq numëron edhe 24 fitore.

**Krasniqit i rikthehet fitorja e vjedhur nga Boseli**

**10 tetor** - Boksieri shqiptar Robin Krasniqi në muajin tetor është mposhtur nga boksieri Domenic Bosel, vendim i cili u dha nga juria pas 12 rundeve. Krasniqi u ankua dhe në muajin dhjetor, në praninë e pesë gjyqtarëve, është bërë rivlerësimi i ndeshjes dhe Robin Krasniqi është shpallur fitues.

**Serbia nuk lejon boksierët e Kosovës të marrin pjesë në Kampionatin Botëror**

**1 nëntor** - Delegacioni i Kosovës në boks tri herë radhazi nuk u lejua të hyjë në Serbi për të marrë pjesë në pjesë në Kampionatin Botëror të Boksit. Komiteti Olimpik i Kosovës ka deponuar ankesën në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (KON/IOC) dhe është kërkuar nga shtëpia e Lëvizjes Olimpikë në botë, t'i marrë të gjitha veprimet e duhura ndaj organizatorëve të botërorit të boksit dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në moslejimin e hyrjes të ekipit të boksit të Kosovës në Serbi.



Serbia nuk lejon boksierët e Kosovës të marrin pjesë në Kampionatin Botëror





Kosova shijon fitoren e parë në parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2025

### Kosova e mbyll cilin kualifikues në pozitën e pestë. Shkarkohet Challandes

**16 nëntor** - Kosova e ka mbyllur me barazim ciklin kualifikues për Botërorin "Katari 2022". "Dardanët" në stadiumin olimpik "Spyros Louis" në Athinë kanë barazuar me Greqinë, 1-1. Grekët shënuan të parët në fund të pjesës së parë me anë të Giorgos Masouras. Rezultatit e barazoi Amir Rrahmani. "Dardanët" e mbyllën këtë cikël në pozitën e pestë në Grupin B, me 5 pikë, derisa Greqia në pozitën e tretë me 10 pikë. Ndërsa Bernard Challandes është shkarkuar nga detyra e përzgjedhësit. Strategu zviceran u shkarkua për shkak të mospërbushjes së objektivave. 70-vjeçari Challandes e drejtori Kosovën nga viti 2018.

### Kosova zë vendin e shtatë në Kampionatin Botëror të Karatesë

**19 nëntor** - Përfaqësuesja e Kosovës në karate ka zënë vendin e shtatë në ekipore në Kampionatin Botëror të Karatesë në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe. Karateistët e Kosovës shënuan tri fitore. Në raundin e parë mundën

Afrikën e Jugut, në të dytën Kilin, në të tetën e finales humbën nga Italia, e cila falë kalimit në finale, i mundësoi Kosovës repesazhin. Në repesazh Kosova fitoi ndaj Brazilit, por më pas pësoi humbje nga Kazakistani, duke humbur mundësinë për të luftuar për medaljen e bronzit.

### Bajoku shpallet boksieri më i mirë i turneut 'Adem Jashari'

**21 nëntor** - Shpëtim Bajoku është shpallur boksieri më i mirë i turneut të 23-të tradicional ndërkombëtar "Adem Jashari" i cili është mbajtur në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Nga afër turneut e ndoqën presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, kryeministri Albin Kurti, ministri për Kulturë, Rini e Sport, Hajrullah Çeku, zëvendësministria Daulina Osmani dhe drejtues të tjerë nga MKRS-ja, FBoxK-ja dhe doajenë të boksit. Boksieri më i mirë vendor u shpall Patriot Behrami.

### Kosova shijon fitoren e parë në parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2025

**28 nëntor** - Përfaqësuesja e

Kosovës në basketboll ka shënuar fitoren e parë në parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2025. "Dardanët" mundën Danimarkën me rezultat 78:73 në takimin e luajtur në Prishtinë, e që përkoi me festën e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit. Fitorja erdhi pas humbjes nga Norvegjia tri ditë më parë. Para takimit, kapiteni legjendar Edmond Azemi zyrtarizoi pensionimin nga basketbolli aktiv.

### Messi fiton 'Topin e Artë' për herë të shtatë

**29 nëntor** - Futbollisti argjentinas Lionel Messi është fituesi "Topit të Artë" për vitin 2021. Për Messin është çmimi i shtatë i lojtarit më të mirë në botë. Ky çmim ndahet nga "France Football". Messi ka udhëhequr Argjentinën drejt triumfit në Copa America sivjet. Ishte ky suksesi më i madh i tij këtë vit, kurse konkurrentin më të madh për çmimin prestigjioz, Bayernit, Robert Lewandowski. Sulmuesi argjentinas e kishte fituar "Topin e Artë" për herë të parë në vitin 2009. E fitoi edhe në vitet 2010, 2011 e 2012. Më i miri në botë u shpall edhe në vitin 2015 e më pas në vitin 2019. Topi i Artë nuk ishte ndarë vjet për shkak të pandemisë.



KB Ylli fiton titullin në Ligën Unike dhe Superligën e Kosovës

### Kosova pranohet në Federatën Evropiane të Ragbit

**3 dhjetor** - Federata e Ragbit e Kosovës është bërë anëtare me të drejta të plota në Federatën Evropiane të Ragbit. Lajmin e ka bërë me dije vetë Federata e Ragbit të Kosovës përmes një postimi në "Facebook". "Ngjarje historike! Kosova pranohet si anëtare e Rugby Europe pas takimit të 103-të gjeneral të këtij institucioni. Në agjendën e këtij takimi, ndër pikat kryesore, ishte edhe votimi i anëtarëve të rinj të Rugby Europe ku Kosova bëhet anëtarja më e re e institucionit më të lartë të ragbit në Evropë", thuhet në njoftim. Në procesin e anëtarësimit të FRK-së ndihmoi edhe Komiteti Olimpik i Kosovës.

### Verstappeni fiton titullin në Formulën 1

**12 dhjetor** - Max Verstappen është fituesi i kampionatit të Formulës 1 për vitin 2021, duke u bërë kampioni i 34-t me radhë. Garuesi i Red Bullit la pas vetes Lewis Hamiltonin për ta fituar Abu Dhabi Grand Prix në xhiron e fundit të garës. Verstappen bëhet garuesi i katërt me radhë më i ri që shpallet kampion i F1, në moshën

24-vjeçare. Para tij ishin Sebastian Vettel, Lewis Hamiltoni dhe Fernando Alonso.

### Rrahmani, futbollisti i vitit 2021; Krasniqi, futbollisti më i mirë i Superligës

**22 dhjetor** - Kapiteni i përfaqësueses së Kosovës në futboll dhe anëtar i klubit italian Napoli, Amir Rrahmani, është zgjedhur futbollisti më i mirë i vitit 2021 në manifestimin tradicional të FFK-së "Laureatët e Viti". Rrahmani ka treguar formë të jashtëzakonshme gjatë këtij viti si në paraqitjet me ekipin dardan, ashtu edhe me klubin e tij, duke e fituar me meritë çmimin "Fadil Vokrri". Epiteti i futbollistit më të mirë të vitit në BKT Superligë me votat e gazetarëve sportivë i takoi Endrit Krasniqi, i cili dha kontribut të çmuar në rrugën drejt titullit të kampionit, derisa klubi i tij FC Prishtina u nderua me çmimin e klubit më të mirë. Derisa në 11-shën më të mirë të vitit u zgjedhën: Enea Koliqi (Gjilani), Leotrim Bekteshi (Prishtina), Ardian Limani (Drita), Ilir Blakqori (Drita), Armend Thaqi (Ballkani), Arbnor Ramadani (Llapi), Endrit Krasniqi (Prishtina), Valmir Veliu (Llapi), Ermal Krasniqi (Ballkani), Gerhard Progni (Gjilani), Kreshnik Uka (Drenica).



Messi fiton 'Topin e Artë' për herë të shtatë



Verstappeni fiton titullin në Formulën 1





## Ish-partnerja e Lorencos paraqitet e zhveshur

Elena Morali vazhdon të mbetet në qendër të kronikave rozë. Ish-partnerja e Horge Lorencos, si gjithnjë, shfaqet më seksi se kurrë në publikimet në "Instagram". E

ndarë prej kohësh nga ish-piloti i Moto GP-së, modeluesja dhuron rregullisht shou në rrjetet sociale, aty ku nuk mungojnë as fotot nudo.



## Modeluesja gjermane, në lidhje me një tjetër sportist

Modeluesja e njohur gjermane Sofia Thomalla i ka dhënë fund marrëdhënies me portierin e gafave, Loris Karius. Çifti u bë shumë i njohur, duke publikuar foto nga plazhet më të bukura të botës, por duket se pas transferimit të portierit në Turqi, erdhi edhe divorci mes tyre. Megjithatë një bukuroshe si Sofia nuk mund të rrinte shumë kohë "single", pasi tani mediet gjermane raportojnë për një lidhje të saj me tenistin Aleksander Zverev. Të dy njihen prej vitesh, por duket se frekuentimi i shpeshtë kohët e fundit ka bërë që ta çojnë miqësinë në një tjetër stad.



## Aktorja italiane: Zhvishem nëse Interi e fiton Ligën e Kampionëve

Aktorja italiane Stefania Markiona është gati ta kopjojë Sabrina Ferilin. Kjo e fundit premtoi dhe e mbajti fjalën kur Roma fitoi titullin kampione, duke improvizuar një striptiz në festën e trofeut në

stadium. E ftuar në "Tiki Taka", aktorja ka pranuar se është gati të bëjë të njëjtën gjë, por jo për titullin kampion të zikaltërve. "Për titullin jo, pasi tashmë jemi mësuar ta fitojmë, por do ta bëj

një gjë të tillë nëse fitojmë Ligën e Kampionëve", ka thënë aktorja. Një arsye më shumë që tifozët zikaltër të shpresojnë të mrekullia e skuadrës së drejtuar nga Simone Inzagi.



## Gjykata detyron ish-sulmuesin e Anglisë t'ia paguajë 30 mijë dollarë personit që ia gjeti qenin

Daniel Sturridge është bërë protagonist i një ngjarje shumë të rrallë. Ish-sulmuesi i përfaqësueses angleze është detyruar nga një gjykatë në Los Anxhelos që të paguajë 30 mijë dollarë te personi i cili i gjeti qenin e humbur. Në vitin 2019, pas një grabitje në shtëpinë e tij, Sturridge bëri me dije se nga banesa ishte zhdukur edhe qeni Luçi. Ai bëri thirrje në rrjetet sociale asokohe se ishte gati të paguante 30 mijë dollarë për personin që do të sillte përsëri qenin në shtëpinë e tij dhe të nesërmen, muzikanti Foster Uashington, ia gjeti qenin. Sipas Uashingtonit, ai nuk ka marrë kurrë një cent nga Sturridge ndaj e ka denoncuar, duke kërkuar që ta respektojë deklaratën e bërë nëpërmjet rrjetëve sociale. Dhe, së fundmi, një gjykatë në ShBA e ka pranuar këtë kërkesë dhe ka dhënë urdhër që futbollisti ta paguajë personin që i gjeti qenin. Vetë Sturridge iu drejtua përsëri rrjetëve sociale duke deklaruar se personit i cili i kishte sjellë qenin përsëri, i kishte dhënë një shpërblim. "Kam video, audio dhe foto të asaj dite. Kam prova për gjithçka", shkruan sulmuesi në rrjetet sociale.

## Gruaja e Mario Gotzes 'ngrit temperaturat' në rrjetet sociale

Ann Kathrin Brommel, bashkëshortja e fantazistit gjerman Mario Gotze, ka zënë faqet e para të medieve rozë, pasi ka publikuar një set fotografik me të brendshme, duke "ngritur temperaturat" në rrjetet sociale. Gjermania 32-vjeçare është e njohur si modele dhe ka pozuar shpesh për kompani të ndryshme mode, teksa këtë herë i është dashur të reklamojë një linjë të brendshmesh.







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022, nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 26.2 dhe 39.2 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; si Vendimit Nr. 2703 të datës 30.12.2021 dhe Vendimit Nr. 2704 të datës 30.12.2021 dhe Vendimit Nr. 2704 të datës 31.12.2021, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

### KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

**1. Pozita:** Auditor për auditim financiar dhe pajtueshmërisë;  
**Numri i referencës:** RAAFP/ZKA/01-01/22  
**Grada:** ZKA-A7  
**Numri i pozitave:** Dy (2)  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë bazuar në planin vjetor dhe në Manualin e ZKA-së, i cili është i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe i raporton UE dhe DD (nëse kërkohet);
- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e planifikimit, të dosjeve të auditimit, në shkrimin e memove të komponentëve, draft raporteve të Auditimit, dhe komentëve eventuale që ndërlihen me to dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shfrytëzon gjykimet profesionale dhe teknikave dhe saktë analitike për të arritur deri të konkluzionet e qëndrueshme në bazë të dëshmiave të mbledhura gjatë procesit të auditimit;
- Shkrimi i rrjedhshëm i Letrave të punës së auditimit duke i strukturuar gjetjet sipas të gjitha elementeve, si dhe të nxjerr konkluzione këshilla/rekomandime të qarta për çështjet e trajtuara që mund t'i ndihmojnë entitetit të audituar;
- Kompletimi dhe Indeksimi i Letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e pacaktuara nga metodologjia dhe me kohë i dorëzon të UE, për t'i arritur planet e aprovuar nga Menaxhmenti;
- Ndihmon ekipin dhe departamentin rreth përdorimit të teknikave audituese, teknologjisë informative, po ashtu ndihmon UE dhe DD për punë dhe detyra tjera sipas kërkesave dhe udhëzimeve të tyre;
- Ofron bashkëpunim dhe komunikim të mirë me anëtarët e ekipit, me departamentin, dhe me sektorët e tjerë në kuadër të ZKA-së si: administrata, financat, burimet njerëzore dhe transporti, gjithmonë në kohë dhe mënyrë racionale;
- Të ruajë dhe azhurnoj njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregon gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat të dakorduara me UE gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ZKA, dhe tregon integritet të lartë dhe vepron në pajtim me kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së; dhe
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale që mund të kërkohen nga UE dhe DD të tij/saj.

#### Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Certifikatë për auditim të jashtëm (kontabilist i certifikuar ose auditor i sektorit publik);
- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike, prej tyre, së paku tre (3) vite në auditim të jashtëm.

**2. Pozita:** Zyrtar për përkrahje të sistemeve;  
**Numri i referencës:** RZPS/ZKA/04-01/22  
**Grada:** ZKA-C4  
**Numri i pozitave:** Një (1)  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon në menaxhimin e sistemit elektronik të menaxhimit të auditimit dhe sistemeve tjera në ZKA;
- Ofron mbështetje për personelin e ZKA-së, nga fusha e sistemeve softuerike.
- Ndihmon në menaxhimin e roleve të përdoruesve të sistemeve të brendshme;
- Mbështet Specialistin për teknologji të informacionit në menaxhimin e bazës së të dhënave të sistemeve të brendshme të ZKA-së.
- Përpilon raporte ad-hoc nga baza e të dhënave dhe azhurnon shabllonet e dokumenteve sipas kërkesave.
- Shërben si help-desk për çdo kërkesë apo ndihmë që paraqitet nga personeli i ZKA-së në lidhje me sistemet e brendshme.
- Menaxhon me detyra administrative që lidhen me mbështetjen e sistemeve në ZKA.
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së mbikqyrësit.

#### Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së informacionit.

#### Informata e përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për vendet e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykatë që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 01.01.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 16.01.2022, ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, Plana za zapošljavanje radnika za 2022. godinu, članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 26.2 i 39.2 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; kao i Odluke Br. 2703 datuma 30.12.2021 godine i Br. 2704 datuma 31.12.2021, Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

### KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

**1. Položaj:** Revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti;  
**Broj reference:** RAAFP/NKR/01-01/22  
**Nivo:** ZKA-A7  
**Broj radnih mesta:** Dva (2)  
**Trajanje imenovanja:** Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Vrši finansijske revizije i revizije usklađenosti na osnovu godišnjeg plana i Priručnika NKR-a, koji je zasnovan na Međunarodnim standardima revizije i izveštava VT i DD (ako se zahteva);
- Pomaže VT u prikupljanju preliminarnih informacija o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi planiranja, revizijskih dosijea, pisanju memoranduma o komponentama, nacrtu izveštaja o reviziji i svih eventualnih komentara i drugih poslova u vezi sa revizijom;
- Koristi profesionalne prosudbe i tačne analitičke tehnike da bi došao do doslednih zaključaka na osnovu dokaza prikupljenih tokom procesa revizije;
- Tečno pisanje revizorskih radnih papira strukturirajući nalaze prema svim elementima, kao i davanje jasnih saveta/preporuka o adresiranim pitanjima koja mogu pomoći subjektu revizije;
- Kompletiranje i indeksiranje radnih papira za revidirane teme (uzorke) i oblasti i svi dokumenti (uključujući i one primljene u Entitetima) moraju biti u skladu sa formatom i zahtevima utvrđenim metodologijom i blagovremeno dostavlja kod VT, kako bi postigao odobrenje planove od strane Menadžmenta;
- Pomaže timu i odeljenju u korišćenju revizorskih tehnika, informacione tehnologije, takođe pomaže VT i DD za druge zadatke i zadatke prema njihovim zahtevima i uputstvima;
- Pružiti dobru saradnju i komunikaciju sa članovima tima, odeljenjem i drugim sektorima u okviru NKR kao što su: administracija, finansije, ljudski resursi i transport, uvek blagovremeno i racionalno;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT tokom procene učinka za prethodnu godinu, i da pohađa obuke koje organizuje NKR koje se povezuju sa Kontinuiranim Profesionalnom Obrazovanjem;
- Da bude odgovoran u vršenju dužnosti za realizaciju ciljeva NKR-a, i pokazuje visok integritet i ponaša se u skladu sa Kodeksom etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i izvan NKR-a; i
- Obavlja i druge stručne zadatke koje može zahtevati od njegovog/njenog VT i DD.

#### Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Sertifikat za spolnu reviziju (ovlašćeni računovođa ili revizor javnog sektora);
- Pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi, od čega najmanje tri (3) godine u spolnoj reviziji.

**2. Položaj:** Službenik za podršku sistema;  
**Broj reference:** RZPS/NKR/04-01/22  
**Nivo:** ZKA-C4  
**Broj radnih mesta:** Jedno (1)

**Trajanje imenovanja:** Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u upravljanju elektronskim sistemom upravljanja revizijom i drugim sistemima u NKR;
- Pružiti podršku osoblju NKR, u oblasti softverskih sistema.
- Pomaže u upravljanju ulogama korisnika internih sistema;
- Podržava specijalistu za informacione tehnologije u upravljanju bazom podataka internih sistema NKR-a.
- Sastavlja ad-hoc izveštaje iz baze podataka i ažurira šablone dokumenata po zahtevu.
- Služi kao help-desk za sve zahteve ili pomoć koje podnese osoblje NKR-a u vezi sa internim sistemima.
- Upravlja administrativnim poslovima vezanim za podršku sistema u NKR.
- Obavlja i druge poslove po zahtevu nadzornika.

#### Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna je sertifikacija iz oblasti informacionih tehnologija.

#### Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

#### Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

#### Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 01.01.2022. godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 16.01.2022.godine do 16.00 časova.

Obrazi za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Belaška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.





### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "SWIPE N'CLEAN" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811463231, Mitrovicë dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SWIPE N'CLEAN" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811463231, Mitrovicë ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "SWIPE N'CLEAN" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811463231, Mitrovicë the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



### IMN "TULLTORJA" sh.p.k

Landovicë - PRIZREN  
20000 - PRIZREN  
NUI : 810514481  
TVSH : 330051607  
Numri fiskal: 600124309

Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i kompanisë I.M.N. "Tulltorja" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e bllokave dhe produkteve nga argjila, Landovicë, zona kadastrale Piranë, Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 21.01.2021, në ora: 12:00, në hapësirat e Restaurant KAG Oil i cili gjendet tek rrethi i autostrades (dalja veri), Komuna e Prizrenit, do të organizohet debat publik nga operatori i kompanisë I.M.N. "Tulltorja" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e bllokave dhe produkteve nga argjila, Landovicë, zona kadastrale Piranë, Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Fatmir Susuri shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Zejnep Pulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren
- ▶ Ismet Sezairi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren
- ▶ Elza Memaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Ibrahim Fehmiu" Prizren
- ▶ Valon Temaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Hysni Temaj" Kushnin
- ▶ Hajdin Xhahaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Leke Dugagjini " Prizren
- ▶ Mentor Recha B.I shpallë te pavlefshme certifikatën me nr fiskal 602433279 dhe certifikatën e TVSH-se me nr 330465329
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
  - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
  - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
  - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
  - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
  - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
  - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
  - ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
  - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
  - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

